



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Tiranë – E mërkurë, 15 mars 2017

PËRMBAJTJA

	Faqe	
Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 13, datë 20.2.2017	Me objekt: shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën të vendimit nr. 00-2015-3429 (390), datë 10.6.2015, të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë.....	3115
Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 14, datë 27.2.2017	Me objekt: shfuqizimin si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë të vendimeve nr. 00-2014-2913 (472), datë 18.9.2014, të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë; nr. 2423, datë 20.12.2010, të Gjykatës së Apelit Tiranë; nr. 4635, datë 7.6.2010, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë; - Dërgimin e çështjes për rigjykim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë.....	3120
Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 15, datë 1.3.2017	Me objekt: shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë të vendimit nr. 80, datë 10.3.2016 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.....	3124
Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 16, datë 1.3.2017	Me objekt: shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë të ligjit nr. 142/2015, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, të ndryshuar; - pezullimin e zbatimit të ligjit deri në hyrjen në fuqi të vendimit të Gjykatës Kushtetuese.....	3131
Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 17, datë 1.3.2017	Me objekt: shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë të vendimit nr. 00-2015-2877 (344), datë 28.5.2015, të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë.....	3143
Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 18, datë 6.3.2017	Me objekt: shfuqizimin si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë të vendimeve nr. 15, datë 19.12.2012, të Gjykatës së Apelit Vlorë; nr. 00-2015-2122, datë 28.4.2015, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.....	3147



VENDIM
Nr. 13, datë 20.2.2017

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë,
e përbërë nga:

Bashkim Dedja kryetar i Gjykatës Kushtetuese

Vladimir Kristo anëtar i “ “

Altina Xhoxhaj anëtare e “ “

Fatmir Hoxha anëtar i “ “

Gani Dizdari anëtar i “ “

Besnik Imeraj anëtar i “ “

Fatos Lulo anëtar i “ “

Vitore Tusha anëtare e “ “

me sekretare Belma Lleshi, në datën 20.12.2016
mori në shqyrtim, mbi bazë dokumentesh, çështjen
nr. 78/16 Akti që i përket:

KËRKUES: Kosta Pjero, Robert Pjero.

SUBJEKTE TË INTERESUARA: Zyra
Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme
Tiranë, Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të
Paluajtshme Vlorë.

OBJEKTI: Shfuqizimi si i papajtuashëm me
Kushtetutën i vendimit nr. 00-2015-3429 (390),
datë 10.6.2015 të Kolegjit Administrativ të
Gjykatës së Lartë.

BAZA LIGJORE: Nenet 41, 42, 43, 131/f dhe
134/1/i të Kushtetutës së Republikës së
Shqipërisë; neni 6 i Konventës Europiane për të
Drejtat e Njeriut dhe neni 1 i Protokollit nr. 1 të
KEDNJ-së; nenet 27 e vijues të ligjit nr. 8577, datë
10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e
Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”,
i ndryshuar.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Vitore Tusha,
mori në shqyrtim pretendimet me shkrim të
kërkuesve, që kërkuan pranimin e kërkesës,
dokumentacionin e paraqitur nga subjekti i
interesuar, Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive
të Paluajtshme Vlorë, si dhe diskutoi çështjen në
tërësi,

VËREN:

I

1. Kërkuesit janë në lidhje gjinie me njëri-
tjetrin (kushërinj të parë) dhe respektivisht
trashëgimtarë ligjorë të baballarëve të tyre V.P.

dhe M.P. (vëllezër). Sipas kërkuesve, prindërit e
tyre kanë qenë pronarë të një banesë dhe një
sipërfaqe truall të ndodhur në Vlorë. Pas çeljes
së trashëgimisë ligjore kërkuesit i janë drejtuar
Zyrës Vendore të Regjistrimit të Pasurive të
Paluajtshme Vlorë (në vijim “ZVRPP-ja Vlorë”) me
kërkesë për regjistrimin e sipërfaqes 1000 m²
dhe të ndërtesës me sipërfaqe 289 m².

2. Subjekti i interesuar, ZVRPP-ja Vlorë, me
urdhryn nr. 112, datë 7.6.2010, ka refuzuar të
regjistrojë pasuritë dhe të lëshojë certifikatë
pronësie për pasuritë e kërkuesve. Urdhri i
ZRPP-së Vlorë është lënë në fuqi edhe nga Zyra
Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të
Paluajtshme Tiranë (në vijim “ZQRPP-ja Tiranë”) me
urdhryn nr. 990, datë 5.7.2010.

3. Kërkuesit i janë drejtuar Gjykatës së Rrethit
Gjyqësor Vlorë me kërkesëpadi me objekt
shfuqizimin e akteve administrative nr. 112, datë
7.6.2010 dhe nr. 990, datë 5.7.2010 të lëshuara
respektivisht nga ZVRPP-ja Vlorë dhe ZQRPP-
ja Tiranë dhe detyrimin e palës së paditur të bëjë
regjistrimin e ndërtesës dhe të truallit funksional.

4. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë, me
vendimin nr. 1815, datë 6.10.2011, ka vendosur
pranimin pjesërisht të kërkesëpadisë, shfuqizimin
e akteve administrative dhe detyrimin e palës së
paditur të bëjë regjistrimin e ndërtesës dhe të
truallit funksional sipas aktekspertimit topografik
të kryer gjatë shqyrtimit të çështjes.

5. Kundër vendimit të mësipërm ka paraqitur
ankim ZVRPP-ja Vlorë dhe Gjykata e Apelit
Vlorë, me vendimin nr. 714, datë 28.6.2012, ka
vendosur lënien në fuqi të vendimit të mësipërm.

6. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë,
pasi ka marrë në shqyrtim rekursin e ZRPP-së
Vlorë, në dhomën e këshillimit, me vendimin nr.
00-2015-3429 (390), datë 10.6.2015, ka vendosur
ndryshimin e vendimeve nr. 1815, datë 6.10.2011
dhe nr. 714, datë 28.6.2012, si dhe rrëzimin e
padisë.

II

7. **Kërkuesit** i janë drejtuar Gjykatës
Kushtetuese në datën 28.7.2016 duke pretenduar
se vendimi i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së
Lartë është marrë në kundërshtim me standardet
e procesit të rregullt ligjor. Në mënyrë të
përmbledhur ata parashtrajnë se është cenuar:



7.1 E drejta për t'u dëgjuar dhe kontradiktoriteti gjatë gjykimit të çështjes nga Kolegji Administrativ në dhomën e këshillimit, pasi nuk janë marrë masa për njoftimin e kërkuësve për datën e seancës, me qëllim që ata të merrnin pjesë në proces dhe të parashtronin prapësimet e tyre edhe mbi bazën e dokumenteve.

7.2 Parimi i gjykatës së caktuar me ligj, pasi Kolegji Administrativ edhe pse arsyeton në vendim se “*paditësit dubet të orientoheshin të zhvillojnë proces civil për detyrim njohje pronar mbi sipërfaqet e truallit dhe ndërtesat e poseduar prej tyre*”, jo vetëm nuk e ktheu çështjen për rishqyrtim, por vendosi rrëzimin e padisë. Për më tepër, parashikimi për paraqitjen e planvendosjes parashikohej nga dekreti nr. 5747, datë 21.1.1983, ndërkohë që leja e ndërtimit të kërkuësve është e vitit 1970.

7.3 Kolegji Administrativ ndonëse shprehet në dispozitiv për “ndryshim vendimi”, duke iu referuar nenit 63 të ligjit nr. 49/2012, *de facto* i ka prishur vendimet dhe ka rrëzuar padinë duke shqyrtuar themelin e çështjes, në tejkallim të kompetencave kushtetuese rishikuese të parashikuara në nenin 141 të Kushtetutës.

8. **Subjektet e interesuara, Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Vlorë**, nuk kanë parashtruar prapësime me shkrim, por kanë depozituar kopje të dokumentacionit bazë të regjistrimit të pasurisë objekt gjykimi.

III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimitimin e kërkuësve

9. Kërkuësit legjitimohen *ratione personae*, në kuptim të rregullimit kushtetues të neneve 131/f dhe 134 të Kushtetutës dhe *ratione temporis*, pasi kërkesa është paraqitur brenda afatit të parashikuar nga ligji nr. 8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese”, i ndryshuar.

10. Në lidhje me legjitimitimin *ratione materiae*, Gjykata rithekson se kontrolli kushtetues ndaj vendimeve gjyqësore është i kufizuar vetëm në funksion të mbrojtjes së të drejtave kushtetuese të individit për një proces të rregullt ligjor. Problemet e interpretimit dhe të zbatimit të ligjit për zgjidhjen e çështjeve konkrete nuk përbëjnë juridiksion kushtetues, nëse ato nuk shoqërohen

me cenimin e këtyre të drejtave (*shih vendimet nr. 22, datë 22.7.2009; nr. 31, datë 5.7.2011 të Gjykatës Kushtetuese*).

11. Bazuar në jurisprudencën kushtetuese, Gjykata Kushtetuese ndërhyt në ato raste kur, përmes veprimeve të tyre, gjykatat e zakonshme cenojnë të drejtën për një proces të rregullt ligjor. Në këto raste, Gjykata nuk bën rivlerësimin e fakteve dhe të rrethanave, por një vlerësim të natyrës kushtetuese, të dallueshëm nga ai i gjykatave të juridiksionit të zakonshëm. Gjykata e analizon ligjin, faktin dhe rrethanën përkatëse në atë dimension që ka ndikim mbi të drejtat dhe liritë e parashikuara nga nenet 42 dhe 131/f të Kushtetutës, gjë e cila përbën juridiksionin e saj kushtetues. Detyra e Gjykatës nuk është zgjidhja e një mosmarrëveshjeje juridike për çështje fakti, por identifikimi i fakteve të natyrës kushtetuese, të cilat shërbejnë për realizimin e kompetencave të saj dhe përbëjnë elementin thelbësor në përcaktimin e autoritetit të një gjykimi kushtetues (*shih vendimet nr. 14, datë 3.6.2009; nr. 16, datë 19.4.2013 të Gjykatës Kushtetuese*). Në këtë kuptim, interpretimi i ligjit, zbatimi i tij në çështjet konkrete, si dhe vlerësimi i fakteve dhe rrethanave janë çështje që ndajnë juridiksionin e gjykatave të zakonshme nga juridiksioni kushtetues (*shih vendimet nr. 22, datë 22.7.2009; nr. 31, datë 5.7.2011; nr. 3, datë 19.2.2013 të Gjykatës Kushtetuese*).

12. Në rastin në shqyrtim, Gjykata vlerëson se kërkuësit nuk kanë në dispozicion mjet tjetër për të kundërshtuar vendimin e Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë. Për këtë arsye ata legjitimohen t'i drejtohet me kërkesë kësaj Gjykate, pasi edhe pretendimet e tyre *prima facie* bien në fushën e veprimit të nenit 42 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ-së. Në këtë kuptim, ato do të shqyrtohen në vijim në këndvështrim të standardeve që imponon procesi i rregullt ligjor në kuptimin kushtetues.

B. Për pretendimin e cenimit të së drejtës për t'u dëgjuar

13. Kërkuësit kanë pretenduar se shqyrtimi i çështjes nga Kolegji Administrativ në dhomën e këshillimit pa praninë e palëve dhe pa u dëgjuar, u ka mohuar të drejtën për të mbrojtur pretendimet e tyre.

14. Gjykata në jurisprudencën e saj ka përcaktuar disa standarde kushtetuese, të cilat janë



të lidhura nga pikëpamja organike dhe funksionale në mënyrë të tillë që cenimi i njërit standard ndikon në mënyrë të pashmangshme në cenimin e të tjerave. Konkretisht, e drejta për t'u njoftuar për një gjykim dhe pjesëmarrja në të është e lidhur me vendimmarrjen e gjykatës, e cila ndikon drejtpërsëdrejti mbi të drejtat subjektive ose interesat e ligjshëm të individit. E drejta për t'u njoftuar për të marrë pjesë në gjykim u paraprin të drejtave të tjera, pasi nëse pala ndërgjyqëse nuk njoftohet për datën dhe orën e seancës, ajo detyrimisht do të gjendet në pamundësi objektive për të ushtruar të drejtat që i garantohen nga neni 42 i Kushtetutës në kuadrin e një procesi të rregullt ligjor. Nga ana tjetër, e drejta për të marrë pjesë në gjykim krijon të njëjtat mundësi për të paraqitur prova dhe argumente në mbrojtje të interesave vetjakë në raport me palën kundërshtare (*shih vendimin nr. 31, datë 26.5.2014 të Gjykatës Kushtetuese*).

15. Parimi i barazisë së armëve nënkupton se çdokush që është palë në proces duhet të ketë mundësi të barabarta që të paraqesë çështjen e tij dhe se asnjë palë nuk duhet të gëzojë avantazh të konsiderueshëm ndaj palës tjetër, por duhet të përcaktohet një ekuilibër i drejtë mes tyre. E drejta për të marrë pjesë në gjykim nuk duhet konsideruar si një e drejtë formale, ku palëve t'u garantohet thjesht prania fizike gjatë procesit civil, por duhet që legjislacioni procedural, në radhë të parë, dhe, më pas, gjyqtari gjatë gjykimit t'u japin mundësi të barabarta palëve për të paraqitur argumente dhe prova në mbrojtje të interesave të tyre. Nëse nuk do të ekzistonte barazia e armëve në gjykimin civil, atëherë argumentet e njëres palë do të prevalonin mbi argumentet e palës së cenuar dhe, për rrjedhojë, e drejta për të marrë pjesë në gjykim do të zhvishej nga funksioni i saj kushtetues për të garantuar një proces të rregullt ligjor (*shih vendimin nr. 34, datë 29.5.2015 të Gjykatës Kushtetuese*). Bazuar në këto parime, Gjykatës së Lartë i dalin një sërë detyrash, mes të cilave rëndësi të veçantë merr krijimi i mundësive të barabarta për pjesëmarrjen e palëve apo përfaqësuesve të tyre në proces, si dhe mundësia e deklarimit të tyre për faktet, provat dhe vlerësimet ligjore që janë të lidhura ngushtë me çështjen që shqyrtohet në gjykatë (*shih vendimin nr. 34, datë 29.5.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

16. Gjykata vëren se ligji nr. 49/2012 "Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve

administrative" parashikon, mes të tjerash, edhe procedurën e gjykimit të mosmarrëveshjeve administrative. Sipas nenit 59 të ligjit, pala kundër të cilës është bërë rekurs mund të kundërshtojë pretendimet e ngritura në rekurs brenda 15 ditëve nga komunikimi i rekursit dhe mosparaqitja e kundërrekursit brenda këtij afati sjell humbjen e së drejtës për të paraqitur pretendimet në një fazë të mëvonshme në Gjykatën e Lartë. Dërgimi i dosjes në Gjykatën e Lartë bëhet brenda 10 ditëve nga data e përfundimit të komunikimeve të rekursit e kundërrekursit palëve ndërgjyqëse në proces (neni 60). Për sa i përket shqyrtimit të rekursit në Gjykatën e Lartë, neni 61 i ligjit parashikon se ai bëhet, si rregull, mbi bazë dokumentesh në dhomë këshillimi. Për efekt të gjykimit gjyqtari relator cakton datën dhe orën për shqyrtimin e çështjes në dhomë këshillimi, duke urdhëruar njoftimin e palëve dhe sekretaria e gjykatës njofton me shpallje ditën dhe orën e shqyrtimit të rekursit, si dhe përbërjen e trupit gjykues të paktën 21 ditë përpara. Po ashtu, ligji ka parashikuar edhe rastet kur çështja shqyrtohet në seancë gjyqësore me praninë e palëve (neni 62).

17. Në rastin në shqyrtim, nga aktet e dosjes gjyqësore të administruar për efekte të gjykimit, Gjykata konstaton se Gjykata e Lartë është vënë në lëvizje me rekursin e subjektit të interesuar, ZRPP-ja Vlorë, i paraqitur në datën 10.10.2012 (nr. 7022 prot). Kërkuesit kanë marrë dijëni personalisht për rekursin në datën 22.10.2012 (data e vulës postare). Me vendimin e datës 19.5.2015, gjyqtari relator i çështjes ka vendosur shqyrtimin e çështjes në dhomë këshillimi në datën 10.6.2015, duke urdhëruar sekretarinë të bëjë njoftimin e palëve për orën dhe datën e caktuar. Sipas procesverbalit të seancës gjyqësore të datës 10.6.2015 rezulton se Kolegji Administrativ ka vlerësuar se palët kanë marrë dijëni rregullisht sipas ligjit dhe ka marrë në shqyrtim vetëm shkaqet e ngritura në rekurs nga subjekti i interesuar ZRPP-ja Vlorë, ndërkohë që nuk rezulton që kërkuesi të ketë paraqitur kundërrekurs ose parashtrime me shkrim ndaj pretendimeve të palës tjetër. Sipas procesverbalit të seancës gjyqësore rezulton se "palët ndërgjyqëse në proces kanë dijëni rregullisht sipas ligjit me shpalljen publike të datës 19.5.2015". Në përfundim të procesit Kolegji Administrativ ka vendosur ndryshimin e vendimit nr. 1815, datë 6.10.2011



të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë dhe vendimit nr. 714, datë 28.6.2012 të Gjykatës së Apelit Vlorë, si dhe rrëzimin e padisë.

18. Gjykata rithekson se ligji nr. 49/2012 u garanton palëve në procesin administrativ të drejtën që jo vetëm të njihen në kohë me pretendimet e palës tjetër, por edhe t'i kundërshtojnë ato apo të paraqesin argumentet e tyre për çështjen. Shqyrtimi i rekursit në dhomën e këshillimit, sipas nenit 480 të KPC-së, si fazë paraprake ku vlerësohet plotësimi i kriterëve për kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë gjyqësore dallon nga shqyrtimi i çështjeve në seancë gjyqësore mbi bazë dokumentesh sipas ligjit nr. 49/2012 për gjykimin e çështjeve administrative. Megjithatë në shqyrtimin e çështjeve administrative Gjykata, përgjithësisht, procedon me shqyrtimin jo në seancë publike me praninë e palëve, por në dhomë këshillimi mbi bazën e dokumenteve të paraqitura, kjo nuk nënkupton se ky lloj gjykimi përjashton detyrimin për njoftimin e rregullt të palëve në mënyrë që të mbrohen në procesin gjyqësor ku janë palë me anë të paraqitjes së komenteve apo prapësimeve lidhur me pretendimet e palës që ka vënë në lëvizje gjykatën. Qëllimi i ligjvënësit në krijimin e gjykatave administrative ka qenë thjeshtimi i procedurave me objekt zgjidhjen e mosmarrëveshjeve administrative, por duke garantuar mbrojtjen efektive të të drejtave subjektive dhe interesave të ligjshëm të personave nëpërmjet një procesi të rregullt gjyqësor dhe brenda afateve të shpejta e të arsyeshme (*shih vendimin nr. 76, datë 16.12.2016 të Gjykatës Kushtetuese*).

19. Gjykata në raste të ngjashme ka vlerësuar se Gjykata e Lartë, pavarësisht nëse i shqyrton çështjet në seancë të hapur publike apo mbi bazë dokumentesh, ka detyrimin të verifikojë nëse palët në proces kanë marrë dijeni efektivisht për rekursin dhe procesin, me qëllim garantimin e së drejtës së mbrojtjes dhe barazisë së armëve në gjykim (*shih vendimet nr. 29, datë 19.5.2016; nr. 21, datë 4.4.2016; nr. 65, datë 7.11.2016 të Gjykatës Kushtetuese*). Në kuadër të garantimit të procesit të rregullt gjyqësor, Gjykata e Lartë ka detyrë të marrë masat për njoftimin e rregullt të subjekteve që potencialisht mund të preken nga procesi, në mënyrë që debati gjyqësor të zhvillohet në respektim të parimit të barazisë së armëve dhe

kontradiktoritetit (*shih vendimin nr. 21, datë 4.4.2016 të Gjykatës Kushtetuese*).

20. Në vështrim të sa më sipër, Gjykata vlerëson se Kolegji Administrativ duke mos marrë masat e nevojshme për t'u garantuar kërkesve të drejtën për t'u dëgjuar dhe për t'u mbrojtur nëpërmjet dhënies së mundësisë së paraqitjes së prapësimeve të tyre, nuk ka respektuar të drejtën e tyre për një proces të rregullt ligjor në drejtim të respektimit të parimit të barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit në gjykim.

21. Në këtë kuptim, Gjykata vlerëson se pretendimi i kërkesve është i bazuar.

C. Për pretendimin për cenimin e parimit të gjykatës së caktuar me ligj

22. Kërkesit kanë pretenduar se Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë ka tejkaluar kufijtë e shqyrtimit të çështjes, pasi duke e zgjidhur çështjen në themel ajo ka funksionuar si gjykatë fakti, duke pranuar rrethana të ndryshme nga ato të provuara nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë dhe Gjykata e Apelit Vlorë në lidhje me origjinën e pronësisë së ndërtesave dhe të truallit funksional.

23. Gjykata ka vlerësuar se një nga elementet e procesit të rregullt ligjor, sipas nenit 42 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ-së, është edhe shqyrtimi i çështjes nga një gjykatë e caktuar me ligj. Ky element karakterizohet nga funksioni i saj gjyqësor, që ka të bëjë me zgjidhjen e çështjeve nga organe të ngarkuara me ligj për të dhënë drejtësi. Përveç këtij kushti, këto organe duhet të shqyrtojnë dhe të vendosin mbi çështje që janë në kompetencë të tyre gjatë një procesi të zhvilluar mbi një procedurë ligjërishit të përcaktuar dhe në pajtim me rendin juridik. E drejta e çdo pale për t'u dëgjuar në seancë përpara një gjykate kompetente dhe të caktuar me ligj nënkupton që gjykata të ketë juridiksion për të gjykuar çështjen dhe që kompetenca për të vendosur për të t'i jetë njohur nëpërmjet ligjit (*shih vendimin nr. 2, datë 22.1.2014 të Gjykatës Kushtetuese*).

24. Për gjykimin që zhvillohet në Gjykatën e Lartë jurisprudenca kushtetuese në mënyrë të vazhdueshme ka vlerësuar se ai lidhet me shqyrtimin e ligjshmërisë së vendimeve të marra nga gjykatat më të ulëta, ndërsa nxjerrja e konkluzionit mbi bazën e vlerësimit të ndryshëm të



provave, nga vlerësimi i dy gjykatave të shkallëve më të ulëta, nuk pajtohet me natyrën e gjykimit në Gjykatën e Lartë. Gjykata e Lartë nuk e ka kompetencën të konkludojë për provat, duke u nisur nga një tjetër vlerësim që kanë bërë gjykatat e shkallës së parë dhe të apelit. Gjatë shqyrtimit të çështjeve ajo nuk merr prova, por shqyrton dhe analizon çështjen në drejtim të kontrollit të ligjshmërisë dhe të bazueshmërisë së vendimeve të ankimuar. Një kontroll i tillë konsiston në analizën e plotë të fakteve dhe të rrethanave, të cilat janë pranuar më parë si të vërteta nga gjykata e faktit dhe ajo e apelit, pa i ndryshuar ato (*shih vendimet nr. 7, datë 9.3.2009; nr. 21, datë 4.4.2016 të Gjykatës Kushtetuese*).

25. Në ushtrimin e funksionit të saj si gjykatë e ligjit, Gjykata e Lartë mund të vendosë për themelin e çështjes vetëm nëse mosmarrëveshja mund të zgjidhet në bazë të të njëjtave fakte dhe prova të vlerësuara nga gjyqtari i faktit dhe që përbëjnë bazën e vendimit në të cilin është bërë një interpretim i gabuar i ligjit. Kontrolli i saj duhet të fokusohet vetëm në drejtim të ligjshmërisë dhe bazueshmërisë së vendimeve të ankimuar, pra mbi mënyrën e zbatimit të ligjit nga gjykatat më të ulëta. Gjykata e Lartë nuk mund të anashkalojë apo të lërë pa vlerë prova që janë shqyrtuar dhe vlerësuar nga gjykatat e faktit, si dhe nuk mund të pranojë prova të cilat nuk janë administruar gjatë gjykimin në fakt. Gjykata thekson se kusht për dhënien nga Gjykata e Lartë të një vendimi për themelin e çështjes, në kuptim të nenit 485 të KPC-së, është që jo vetëm të mos nevojitet administrimi i provave të reja, por edhe që provat e administruara të jenë shqyrtuar dhe vlerësuar në mënyrë të mjaftueshme nga gjyqtari i faktit (*shih vendimet nr. 27, datë 24.6.2013; nr. 40, datë 25.6.2015; nr. 21, datë 4.4.2016 të Gjykatës Kushtetuese*).

26. Sipas jurisprudencës kushtetuese, Gjykata e Lartë jo vetëm nuk ka kompetencën të administrojë prova të reja, por as të anashkalojë ekzistencën e fakteve dhe të rrethanave që janë vërtetuar në gjykimin e faktit, t'i ndryshojë ato ose të arrijë në konkluzione për faktet e çështjes që bien në kundërshtim me përfundimet e gjykatave më të ulëta (*shih vendimin nr. 27, datë 24.6.2013 të Gjykatës Kushtetuese*). Në rast se Gjykata e Lartë vlerëson se provat e administruara nuk janë të mjaftueshme për arritjen e një konkluzioni apo se nevojitet kryerja e vlerësimeve të mëtejshme të tyre,

ajo nuk mund të marrë kompetencat e gjykatës të faktit, pasi një veprim i tillë bie ndesh me parimin e gjykatës së caktuar me ligj, por duhet ta kthejë çështjen për rishqyrtim, me qëllim plotësimin e këtyre të metave të vendimit (*shih vendimin nr. 32, datë 25.5.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

27. Në çështjen në shqyrtim, Gjykata konstaton se objekti i gjykimit në themel ka qenë shfuqizimi i akteve administrative të lëshuara nga ZVRPP-ja Vlorë dhe ZRPP-ja Tiranë, si dhe detyrimi i këtyre të fundit të regjistrojnë ndërtesën dhe truallin funksional të pretenduar nga kërkuesit.

28. Nga analiza e vendimeve gjyqësore rezulton se gjykatat e faktit e kanë pranuar padinë e ngritur nga kërkuesit, duke arsyetuar se “... palët kanë plotësisht të provuar origjinën e pronësisë dhe regjistrimin në regjistrat e vjetër të pronësisë. Kjo provohet me vërtetimin nr. 3.10.1980 lëshuar nga hipoteka Vlorë, me anë të të cilit vërtetohet se pasuria e Vasil dhe Vangjel Pjero, e regjistruar në regjistrat e inskriptimeve vol.5, nene 81 e 82, viti 1956... ka qenë e hipotekuar në favor të Bankës së Shqipërisë deri në vitin 1964, kohë kur u shlye kredia bankare dhe aktualisht prona është e lirë nga çdo barrë.”. Në lidhje me pretendimin e palës së paditur për mungesën e planimetrisë, Gjykata Rrethit Gjyqësor Vlorë ka arsyetuar se “referuar dekretit nr. 5747, datë 29.6.1978 “Për hartimin, miratimin dhe zbatimin e planeve rregulluese të qyteteve dhe fshatrave” i ndryshuar, në nenet 8 e 9 parashikonte që ndërtimet e reja për shtëpi banimi brenda vijave kufizuese të ndërtimit në qytet lejoheshin pasi të ishin përgatitur projekti përkatës nga zyra e urbanistikës.”. Për sa i takon aktin të ekspertimit, Gjykata e Apelit Vlorë argumenton se “konstatimi i ekspertës se trualli që kërkohet të regjistrohet në emër të paditësve është i regjistruar në bashkëpronësi të personave të tjerë del jashtë objektit të gjykimit, pasi nuk ka lidhje me shkakun e refuzimit të kërkesës së të paditurve për regjistrim të pasurisë, që siç u theksua mbështetet në mungesën e dokumentacionit provues, por jo në mbivendosje të kësaj pasurie me pasuri të regjistruara më parë në favor të personave të tjerë...”.

29. Në ndryshim nga përfundimet e arritura nga gjykatat e faktit, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë ka vlerësuar: “Urdhri nr. 990, datë 5.7.2010 i ZRPP-së Tiranë është i drejtë dhe në konformitet me dispozitat ligjore dhe nënligjore. Në dokumentacionin e paraqitur nga kërkuesit nuk rezulton të jetë paraqitur akti që përbën titull të detyrueshëm për regjistrim, për të vërtetuar pronësinë mbi pasurinë në fjalë sipas përcaktimeve të nenit 24/a të ligjit nr. 7843, datë 13.7.1994, të ndryshuar dhe



nënenit 194 të Kodit Civil. Gjithashtu nuk rezulton të jetë administruar asnjë akt ligjor, i cili të vërtetojë apo të bëjë të mundur vërtetimin e ekzistencës së ndonjë transaksioni të pasurisë së regjistruar në regjistrat e inskriptimeve nr. 81 e 82, viti 1956 në favor të Kosta Pjero, i cili pretendon pronësinë mbi këtë pasuri. Leja e meremetimit nr. 17, datë 6.5.1970 lëshuar në favor të Vasil Pjero nuk rezulton të jetë e shoqëruar nga planvendosja përkatëse e miratuar nga organi shtetëror kompetent. Në asnjë moment gjatë gjykimit nuk është provuar origjina e pronës së trashëgimlënësve të paditësve. Truallit i pretenduar është në pronësi të familjes Sharra, i kthyer në natyrë me vendim të KKKP-së, pra një regjistrim i tillë do të krijonte mbivendosje me një pasuri të regjistruar më parë dhe ndodhur në këto kushte duhet të orientoheshin paditësit të zhvillonin një proces civil “detyrim për njohje pronarë mbi sipërfaqen e truallit dhe ndërtesa e poseduara prej tyre”.

30. Bazuar në standardet e mësipërme dhe rrethanat e çështjes konkrete, Gjykata vlerëson se Kolegji Administrativ, në kushtet e arritjes së një përfundimi të ndryshëm nga gjykatat më të ulëta, bazuar në përcaktimet e nenit 63 të ligjit nr. 49/2012, duhet t'i prishte të dyja vendimet gjyqësore dhe ta kthente për rigjykim çështjen. Gjykata rithekson se në asnjë rast Kolegji Administrativ nuk mund ta zgjidhë vetë çështjen në themel, duke rivlerësuar ndryshe faktet dhe provat e marra gjatë gjykimit nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë dhe Gjykata e Apelit Vlorë.

31. Në përfundim, Gjykata vlerëson se Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë ka vepruar tej kompetencave të tij ligjore, duke cenuar parimin e gjykatës së caktuar me ligj, si një nga elementet e së drejtës për një proces të rregullt ligjor.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 131/f dhe 134/1/i të Kushtetutës, si dhe të neneve 72 e vijues të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me shumicë votash,

VENDOSI:

- Pranimin e kërkesës.
- Shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë të vendimit nr. 00-2015-3429(390), datë 10.6.2015 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë.

- Dërgimin e çështjes për rishqyrtim në Gjykatën e Lartë.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë pro: Bashkim Dedja (kryetar),
Vladimir Kristo, Besnik Imeraj, Gani Dizdari,
Fatmir Hoxha, Vitore Tusha, Fatos Lulo,
Anëtarë kundër: Altina Xhoxhaj

VENDIM

Nr. 14, datë 27.2.2017

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Bashkim Dedja kryetar i Gjykatës Kushtetuese			
Vladimir Kristo	anëtar i	“	“
Vitore Tusha	anëtare e	“	“
Altina Xhoxhaj	anëtare e	“	“
Fatmir Hoxha	anëtar i	“	“
Gani Dizdari	anëtar i	“	“
Besnik Imeraj	anëtar i	“	“
Fatos Lulo	anëtar i	“	“

me sekretare Edmira Babaj, në datën 20.12.2016 mori në shqyrtim në seancë plenare, mbi bazë dokumentesh, çështjen me nr. 70/10 Akti që i përket:

KËRKUES: Bajram Farruku

SUBJEKTE TË INTERESUARA: Polikseni Shehu, Liljana Kajana, Thanas Kajana, Kiti Kajana, Agjencia e Trajtimit të Pronave (ATP), Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme (ZRPP) Tiranë.

OBJEKTI: Shfuqizimi si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë i vendimeve nr. 00-2014-2913 (472), datë 18.9.2014 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë; nr. 2423, datë 20.12.2010 të Gjykatës së Apelit Tiranë; nr. 4635, datë 7.6.2010 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Dërgimi i çështjes për rigjykim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

BAZA LIGJORE: Nenet 41, pikat 1 dhe 2, 42, 43, 131/f dhe 134/1/i të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; ligji nr. 8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.



GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Fatos Lulo, mori në shqyrtim pretendimet me shkrim të kërkuarit, Bajram Farruku, që kërkoj pranimin e kërkesës, prapësimet me shkrim të subjektit të interesuar, ATP-së, që kërkoj rrëzimin e kërkesës, si dhe diskutoj çështjen në tërësi,

VËREN:

I

1. Kërkuari Bajram Farruku pretendon se është pronar i një banese me oborr të ndodhur në Tiranë. Këtë pretendim kërkuari e mbështet në vendimin nr. 33, datë 17.1.1961 të Gjykatës Popullore Tiranë me objekt vërtetim gjyqësor fakti (ku trashëgimlënësi i kërkuarit ka ndërnuar një shtëpi të përbërë prej dy odash, kuzhinë e sallon), si dhe në lejen e ndërtimit nr. 82, datë 31.5.1972 në emër të kërkuarit me objekt shtesën e një dhome ngjitur me ekzistuesen.

2. Me vendimin e datës 14.10.1975 të Gjykatës së Rrethit Tiranë është vendosur pjesëtimi i kësaj pasurie ndërmjet kërkuarit dhe vëllait të tij sipas pjesëve takuese, ku kërkuari ka përfutuar gjysmën e pasurisë.

3. Me vendimin nr. 463, datë 5.6.1994, Komisioni i Kthimit dhe Kompensimit të Pronave (KKKP) Tiranë ka vendosur të njohë pronar shtetasin Nasi Kajana (trashëgimlënësi i subjekteve të interesuara) mbi një sipërfaqeje toke are të punuar prej 9 dynmësh, si dhe kthimin e një trualli të lirë me sipërfaqe të përgjithshme 4429 m², të përbërë nga tri parcela (parcela 1=2000 m², parcela 2=1700 m², parcela 3=709 m²).

4. Me vendimin nr. 433, datë 9.8.2006 të KKKP-së Tiranë është vendosur: *“Plotësimi i vendimit nr. 463, datë 5.6.1994 të KKKP-së Tiranë: të kthejë të drejtën e pronësisë për pronën prej 3405 m² truall të përbërë nga sipërfaqet e lura SL1=2423,5 m²; SL2=67,5 m²; SL3=160 m²; SL4=754m² subjektit të shpronësuar Nasi Kajana (trashëgimtarëve të tij ligjorë), të ndodhur në rrugën “Todi Shkurti”, zona kadastrave 8190 me këto kufij: veriu prona e vetë, jug me xhade, lindja trashëgimtarët e Sadik Memës dhe perëndim Hysen Xhelepi, në bazë të nenit 18 të ligjit nr. 9235, datë 29.7.2004 “Për kthimin dhe kompensimin e pronës”; t’i kompensojë pronën e mbetur prej 1166 m²”.*

5. Kërkuari duke pretenduar se vendimi nr. 433, datë 9.8.2006 i KKKP-së Tiranë e cenon atë në

pronën e tij, e cila ndodhet brenda pronës së kthyer subjekteve të interesuara, i është drejtuar me kërkesëpadi Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë me objekt konstatimin e pavlefshmërisë absolute të këtij vendimi. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. 4635, datë 7.6.2010, ka vendosur rrëzimin e padisë si të pambështetur në ligj dhe në prova.

6. Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. 2423, datë 20.12.2010, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. 4635, datë 7.6.2010 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

7. Pas rekursit të ushtruar nga kërkuari, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2014-2913 (472), datë 18.9.2014, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. 2423, datë 20.12.2010 të Gjykatës së Apelit Tiranë.

II

8. **Kërkuari Bajram Farruku** i është drejtuar me kërkesë Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) sipas objektit, duke paraqitur këto shkaqe në mënyrë të përmbledhur:

8.1 Vendimi nr. 433, datë 9.8.2006 i KKKP-së Tiranë ka disponuar dy herë në kohë të ndryshme për të njëjtën sipërfaqe trualli, duke kapërcyer kompetencat lëndore të tij, sipas kuptimit të neneve 115/a dhe 116/b të Kodit të Procedurave Administrative.

8.2 Vendimi nr. 433, datë 9.8.2006 i KKKP-së Tiranë është absolutisht i pavlefshëm, sepse vendimi i korigjuar me këtë vendim është goditur gjyqësisht nga palët në gjykim dhe është konsideruar i drejtë nga gjykata.

8.3 Në gjykimin e një tjetër çështjeje me objekt anulimin e vendimeve nr. 463, datë 5.6.1994 dhe nr. 433, datë 9.8.2006 të KKKP-së Tiranë, Gjykata e Lartë ka vendosur dërgimin e çështjes për rishqyrtim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

8.4 Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe Gjykata e Apelit Tiranë për gjysmën tjetër të pronës, e cila i përket vëllait të kërkuarit, në një tjetër proces gjyqësor kanë vendosur në favor të këtij të fundit, duke konstatuar pavlefshmërinë absolute të pjeshme të vendimit nr. 433, datë 9.8.2006 të KKKP-së Tiranë.

9. **Subjekti i interesuar, ATP-ja**, pretendon se kërkesa e paraqitur nga kërkuari nuk përmban asnjë element të cenimit të së drejtës kushtetuese për një proces të rregullt ligjor, duke parashtruar si vijon:



9.1 Vëllai i kërkuessit, shtetasi Q.F., ka pretenduar para gjykatës se vendimi nr. 433, datë 9.8.2006 i KKKP-së Tiranë, i dhënë në emër të familjes Kajana, cenon pronën e tij, pasi është nxjerrë në kapërcim të kompetencave të organit administrativ. Ky shtetas e ka bazuar pretendimin e tij në të njëjtat prova, të cilat ishin marrë në shqyrtim nga gjykata në çështjen e kërkuessit, por në këtë rast i është drejtuar gjykatës për pjesën e tij takuese. Këtë pretendim gjykata e rrethit dhe ajo e apelit e kanë gjetur të bazuar, por ndaj këtyre vendimeve ka ushtruar rekurs ATP-ja dhe çështja është aktualisht në shqyrtim në Gjykatën e Lartë.

III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimitimin e kërkuessit

10. Gjykata vëren se kërkuessi legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të neneve 131/f dhe 134/1/i të Kushtetutës dhe *ratione temporis*, pasi kërkesa është paraqitur brenda afatit ligjor 2-vjeçar të parashikuar në nenin 30/2 të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, i zbatueshëm në çështjen në shqyrtim.

11. Në lidhje me legjitimitimin *ratione materiae*, Gjykata ka theksuar se interpretimi i ligjit, zbatimi i tij në çështjet konkrete, si dhe vlerësimi i fakteve dhe rrethanave janë çështje që ndajnë juridiksionin e gjykatave të zakonshme nga juridiksioni kushtetues. Kontrolli kushtetues që kjo Gjykatë ushtron ndaj vendimeve gjyqësore është i kufizuar vetëm në funksion të mbrojtjes së të drejtave kushtetuese të individit për një proces të rregullt ligjor, kurse problemet e interpretimit dhe të zbatimit të ligjit për zgjidhjen e çështjeve konkrete nuk përbëjnë juridiksion kushtetues nëse ato nuk shoqërohen me cenimin e këtyre të drejtave (*shih vendimin nr. 3, datë 23.2.2016 të Gjykatës Kushtetuese*).

12. Gjykata ndërhyt në ato raste kur, përmes veprimeve të tyre, gjykatat e zakonshme cenojnë të drejtën për një proces të rregullt ligjor. Në këto raste, ajo nuk bën rivlerësimin e fakteve e të rrethanave, por një vlerësim të natyrës kushtetuese, të dallueshëm nga ai i gjykatave të juridiksionit të zakonshëm. Gjykata e analizon ligjin, faktin dhe rrethanën përkatëse në atë

dimension që ka ndikim mbi të drejtat dhe liritë e parashikuara nga nenet 42 dhe 131/f të Kushtetutës, gjë e cila përbën juridiksionin e saj kushtetues. Detyra e Gjykatës nuk është zgjidhja e një mosmarrëveshjeje juridike për çështje fakti, por identifikimi i fakteve të natyrës kushtetuese, të cilat shërbejnë për realizimin e kompetencave të saj dhe përbëjnë elementin thelbësor në përcaktimin e autoritetit të një gjykimi kushtetues (*shih vendimin nr. 62, datë 23.9.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

13. Në kuptim të sa më sipër, Gjykata vëren se pretendimet e kërkuessit për sa i takon procesit të zhvilluar në gjykatat e juridiksionit të zakonshëm për konstatimin e pavlefshmërisë absolute të vendimit nr. 433, datë 9.8.2006 të KKKP-së Tiranë, kanë të bëjnë në thelb me mënyrën e vlerësimit të provave dhe të zbatimit e interpretimit të ligjit nga këto gjykata. Duke qenë me natyrë ligjore dhe jo kushtetuese, zgjidhja e tyre nuk përfshihet në juridiksionin kushtetues, por i përket juridiksionit të gjykatave të zakonshme. Për këto pretendime kërkuessit i është dhënë përgjigje e arsyetuar nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm. Kërkuessi nuk ka arritur t'i ngrejë pretendimet e tij në nivel kushtetues, duke mos arritur të provojë cenimin e standardeve të së drejtës për një proces të rregullt ligjor. Për rrjedhojë, këto pretendime nuk mund të bëhen objekt i kontrollit kushtetues.

B. Për pretendimin e cenimit të parimit të gjësë së gjykuar

14. Kërkuessi pretendon se Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe Gjykata e Apelit Tiranë për gjysmën tjetër të pronës, e cila i përket vëllait të kërkuessit, në një tjetër proces gjyqësor kanë vendosur në favor të këtij të fundit duke konstatuar pavlefshmërinë absolute të pjeshme të vendimit nr. 433, datë 9.8.2006 të KKKP-së Tiranë. Gjithashtu, në gjykimin e një tjetër çështjeje (me paditës familjen Toptani dhe të paditur subjektet e interesuara) me objekt anulimin e vendimeve nr. 463, datë 5.6.1994 dhe nr. 433, datë 9.8.2006 të KKKP-së Tiranë, Gjykata e Lartë ka vendosur dërgimin e çështjes për rishqyrtim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

15. Bazuar në parimin *jura novit curia* Gjykata ka theksuar se ajo mund të vlerësojë vetë nëse pretendimet e ngritura në kërkesë bien në fushën



e veprimit të një dispozite të caktuar, që nuk është parashtruar para saj dhe se ajo nuk e konsideron veten të detyruar nga cilësimi që u është bërë fakteve të çështjes nga kërkuesi (*shih vendimin nr. 27, datë 9.5.2012 të Gjykatës Kushtetuese*). Në këtë kuptim, pavarësisht nga fakti se kërkuesi nuk ka evidentuar konkretisht standardin e cenuar, Gjykata vlerëson se pretendimet e tij se gjykatat e juridiksionit të zakonshëm për sa u takon vendimeve nr. 463, datë 5.6.1994 dhe nr. 433, datë 9.8.2006 të KKKP-së Tiranë (objekt i kërkesëpadisë së kërkuesit) në çështje të ngjashme kanë vendosur në mënyra të ndryshme, duhet të trajtohen në këndvështrim të parimit të gjësë së gjykuar.

16. Gjykata rithekson se dhënia e vendimeve të ndryshme gjyqësore për çështje të njëjta bie ndesh me parimin e sigurisë juridike në praktikën gjyqësore. Parimi i sigurisë juridike nënkupton, ndërmyjet të tjerash, garantimin e besueshmërisë së individit të shteti, institucionet e tij dhe tek aktet që ato nxjerrin. Ndërsa në rastin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë siguria juridike nënkupton se nëse gjykata ka vendosur përfundimisht për një çështje, vendimi i saj nuk duhet të vihet në dyshim. Pra, kur vendimi ka marrë formë të prerë ai është i detyrueshëm për palët, trashëgimtarët e tyre, për personat që tërheqin të drejta nga palët, për gjykatën që ka dhënë vendimin dhe për të gjitha gjykatat dhe institucionet e tjera. Asnjë gjykatë nuk mundet të gjykojë sërish të njëjtën padë kundrejt të njëjtave palë. Vendimi gjyqësor i formës së prerë, që përbën gjë të gjykuar, është shprehje dhe konkretizim i së drejtës mbi marrëdhënien juridike dhe ka qëllim t'i japë jo vetëm qartësi, por edhe siguri kësaj marrëdhënieje (*shih vendimin nr. 21, datë 16.4.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

17. Parimi i gjësë së gjykuar përfshin jo vetëm urdhërimet e dispozitivit të vendimit gjyqësor, por edhe zbatimin e së drejtës së përcaktuar në pjesën përshkruese arsyetuese të vendimit, me kusht që ato të jenë kryer me qëllim dhënien e vendimit gjyqësor dhe t'u përkasin fakteve ose marrëdhënieve që kanë formuar objektin e gjykimit mbi të cilin gjykata ka dhënë vendimin e saj (*shih vendimin nr. 36, datë 25.7.2013 të Gjykatës Kushtetuese*).

18. Të njëjtin qëndrim ka mbajtur edhe Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut, e cila ka nënvizuar se “...në pikëpamjen e Gjykatës, parimi në

bazë të të cilit një vendim përfundimtar i formës së prerë është gjë e gjykuar dhe zgjidh mosmarrëveshjen midis palëve me një efekt përfundimtar është një element themelor i së drejtës për një gjykim të drejtë, që garantohet nga neni 6 i Konventës në çështjet civile. Parimi i sigurisë juridike dikton që kur një mosmarrëveshje civile është shqyrtuar në themel nga gjykata, vendimi i saj nuk vihet më në diskutim” (*shih çështjen Kebaya dhe të tjerë kundër Bullgarisë, datë 12.1.2006*). Kjo Gjykatë, në disa çështje kundër Shqipërisë, ka evidentuar rëndësinë e sigurisë juridike në procesin e kthimit dhe të kompensimit të pronave, veçanërisht për sa u përket të drejtave të fituara nga vendimet që kanë njohur të drejta pronësie dhe të ruajtjes së garancive që lidhen me këto të drejta (*shih Ramadhi dhe të tjerë kundër Shqipërisë, datë 13.11.2007; Hamzaraj kundër Shqipërisë, datë 3.2.2009; Manushaqe Puto dhe të tjerë kundër Shqipërisë, datë 31.7.2012*).

19. Gjykata konstaton se në procesin gjyqësor të iniciuar nga vëllai i kërkuesit (shtetasi Q.F.) Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. 8051, datë 30.7.2014, ka vendosur: “Pranimin e kërkesës së paditësit Q.F. dhe konstatimin e pavlefshmërisë absolute të pjesëme të vendimit nr. 433, datë 9.8.2006 të KKKP-së Tiranë për sipërfaqen 960 m² që përbën mbivendosje me pronën e paditësit Q.F.”. Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. 450, datë 2.3.2016, ka vendosur: “Lënien në fuqi të vendimit nr. 8051, datë 30.7.2014 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë me këtë saktësim: “Anulimin pjesërisht të vendimit nr. 433, datë 9.8.2006 të KKKP-së Tiranë për sipërfaqen 960 m² që përbën mbivendosje me pronën e paditësit Q.F.””. Në bazë të kërkesës së shtetasit Q.F. është lëshuar edhe urdhri i ekzekutimit të vendimit nr. 8051, datë 30.7.2014 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit. Pas këtyre veprimeve subjektet e interesuara (pala e paditur në procesin gjyqësor) kanë paraqitur rekurs në Gjykatën e Lartë. Siç rezulton edhe nga faja zyrtare e Gjykatës së Lartë, statusi i kësaj çështje është akoma në proces studimi dhe nuk ka akoma një vendimmarrje të asaj gjykate për këtë çështjeje.

20. Në lidhje me vendimin nr. 00-2014-2089 (417), datë 26.6.2014 të Gjykatës së Lartë, me objekt anulimin e vendimeve nr. 463, datë 5.6.1994 dhe nr. 433, datë 9.8.2006 të KKKP-së Tiranë, Gjykata vëren se Gjykata e Lartë ka vendosur prishjen e vendimeve gjyqësore të të dyja shkallëve të gjykimit dhe dërgimin e çështjes për rigjykim në gjykatën e shkallës së parë me një tjetër trup



grykues. Për më tepër, Kolegji Civil i Grykatës së Lartë në këtë vendim është shprehur: “Nga studimi i akteve të ndodhura në dosje konstatohet se të dy grykatat e faktit nuk i kanë dhënë një zgjidhje përfundimtare konfliktit midis palëve. Si grykata e shkallës së parë edhe ajo e apelit duke zbatuar jo drejtë ligjin material kanë arritur në përfundimin e gabuar se padia e paditësve L.T., etj., si padi e kërimit të sendit (neni 296 i Kodit Civil) është e parashkruar në referim të dispozitave të Kodit Civil që rregullojnë institutin e parashkrimit... Mbështetur në vendimet unifikuese të lartpërmendura, Kolegji Civil i Grykatës së Lartë duke i konsideruar grykimet e këtij lloji si grykime që në themel të tyre njohin dhe kthejnë pronën e ish-pronarit, trashëgimtarëve të tyre si një e drejtë subjektive, e vlerëson të gabuar përfundimin e arritur nga grykatat e faktit për rrëzimin e padisë për shkakt të parashkrimit referuar nenit 114 të Kodit Civil. Grykatat e faktit kanë vlerësuar se padia në thelb është një padi e kërimit të sendit. Referuar vlerësimit të mësipërm, Kolegji çmon të sjellë në vëmendje qëndrimin e mbajtur nga Kolegjet e Bashkuara të Grykatës në Vendimin Unifikues nr. 5, datë 31.5.2011 në të cilin është arritur në përfundimin njëjësues se: Padia e kërimit të sendit, parashikuar nga neni 296 i Kodit Civil, nga natyra e saj është një padi e paparashkrueshme. Duke qenë se në rastin konkret nuk rezulton që grykatat të ketë parashtruar argumente ligjore në lidhje me pranimin e padisë; ato nuk kanë arsyetuar rrethanat ligjore që përbëjnë thelbin e kërimit të paditësit dhe prapësimeve të të paditurit; nuk kanë evidentuar faktet apo rrethanat ku konsiston cenimi apo ndërhyrja e palës së paditur në të drejtat e pronësisë së palës paditëse që i kufizojnë atij ushtrimin e tagrave të pronësisë, Kolegji çmon prishjen e vendimit të grykatës së apelit dhe grykatës së shkallës së parë dhe dërgimi i çështjes për rishqyrtim në grykatën e shkallës së parë me tjetër trup grykues.”

21. Bazuar në sa më sipër, Grykata vëren se pretendimet e kërkesit jo vetëm kanë të bëjnë me çështje gjyqësore të tjera dhe të ndryshme nga çështja e tij, por nuk rezulton që grykatat të kenë disponuar apo të jenë shprehur në lidhje me pjesën e tij takuese të pasurisë. Gjithashtu, vërehet se këto çështje janë akoma në proces shqyrtimi dhe rishqyrtimi në grykatat e juridiksionit të zakonshëm. Në këto kushte, Grykata vlerëson se këto vendime nuk e vendosin kërkesin në një situatë të pasigurt nga pikëpamja juridike. Për rrjedhojë, Grykata vlerëson se këto pretendime të kërkesit janë haptazi të pabazuara.

22. Nisur nga sa më lart, Grykata, në përfundim të grykimit, vlerëson se kërkesa e paraqitur nga kërkuesi është e pabazuar.

PËR KËTO ARSYE,

Grykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 131/f dhe 134/1/i të Kushtetutës, si dhe të neneve 72 e vijues të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Grykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me shumicë votash¹,

VENDOSI:

- Rrëzimin e kërkesës.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë pro: Bashkim Dedja (kryetar), Vitore Tusha, Gani Dizdari, Fatmir Hoxha, Altina Xhoxhaj, Fatos Lulo, Besnik Imeraj
Anëtarë kundër: Vladimir Kristo

VENDIM

Nr. 15, datë 1.3.2017

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Grykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Bashkim Dedja kryetar	i Grykatës Kushtetuese		
Vitore Tusha	anëtare e	“	“
Vladimir Kristo	anëtar i	“	“
Fatmir Hoxha	anëtar i	“	“
Gani Dizdari	anëtar i	“	“
Fatos Lulo	anëtar i	“	“
Besnik Imeraj	anëtar i	“	“

me sekretare Belma Lleshi, në datën 19.1.2017 mori në shqyrtim në seancë plenare, mbi bazë dokumentesh, çështjen nr. 84/20 Akti, që i përket:

KËRKUESE: Pranvera Duhaxhiu

SUBJEKTE TË INTERESUARA: Nazmije Ferhati, Elida Panganika, Agjencia e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave Tiranë, Drejtoria e Privatizimit të Ndërmarrjeve të Vogla dhe të

¹ Gjyqtari Vladimir Kristo votoi për pranimin pjesërisht të kërkesës vetëm për shfuqizimin e vendimit të Kolegjit Civil të Grykatës së Lartë



Mesme, pranë Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës.

OBJEKTI: Shfuqizimi si i papajtuëshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë i vendimit nr. 80, datë 10.3.2016 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.

BAZA LIGJORE: Nenet 42, 142/1, 131/f, 132 dhe 134/1/g të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; nenet 6/1 e 13 i Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut; ligji nr. 8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, të ndryshuar.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjo i relatorin e çështjes Besnik Imeraj, mori në shqyrtim pretendimet me shkrim të kërkuases, që është shprehur për pranimin e kërkesës, prapësimet me shkrim të subjektit të interesuar, Eleni Panganika, që është shprehur për rrëzimin e kërkesës, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

1. Me vendimin nr. 224/4 prot., datë 17.6.1996, ish-Komisioni i Kthimit dhe Kompensimit të Pronave (KKKP) Elbasan i ka njohur pronësinë trashëgimtarëve të z. Hysen Abdihoxha për një sipërfaqe truall prej 80 m², nga të cilat 21,6 m² truall gjenden nën objektin librari, me një sipërfaqe totale prej 57,6 m², duke i dhënë të drejtën e parablerjes për këtë objekt, kur të privatizohet, dhe kompensim me obligacione për sipërfaqen tjetër prej 58,4 m² të zënë nga një pallat me 5 kate dhe trotuar.

2. Kërkuësja, në cilësinë e një prej trashëgimtarëve të z. Hysen Abdihoxha, i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, duke ankimuar vendimin e KKKP-së Elbasan me pretendimin, ndërmjet të tjerash, se sipërfaqja e truallit nën objektin librari është më e madhe se 21,6 m². Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan, me vendimin nr. 89, datë 21.5.2005, ka vendosur pranimin e kërkesëpadisë, ndryshimin e vendimit nr. 224/4 prot., datë 17.6.1996 të KKKP-së Elbasan, duke u njohur trashëgimtarëve të z. Hysen Abdihoxha të drejtën e parablerjes së librarisë, kur të privatizohet, e cila zë 48 m² të sipërfaqes prej 80 m² të njohur nga ky komision,

dhe kompensim me obligacione për pjesën tjetër të sipërfaqes të zënë nga një pallat me 5 kate dhe trotuar. Ky vendim ka marrë formë të prerë në datën 9.2.2005.

3. Në datën 27.2.2007, subjekti i interesuar Nazmije Ferhati, në cilësinë e qiramarrëses (librashitëse) së objektit librari të lartpërmendur, i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan me objekt kundërshtimin e vendimit nr. 224/4 prot., datë 17.6.1996 të ish-KKKP-së Elbasan. Ajo pretendon se ndërtesa librari nuk ndodhet në sipërfaqen ish-pronë e z. Hysen Abdihoxha, pra nuk ka mbivendosje ndërmjet sipërfaqeve përkatëse. Po ashtu, subjekti i interesuar, paditësja në atë gjykim, Nazmije Ferhati, parashtroi se libraria është pronë shtetërore në administrim të Drejtorisë së Tregtimit të Librit Artistik dhe Shkencor SHA, dhe se aktualisht ekziston një kontratë qiraje ndërmjet saj dhe kësaj drejtorie, pasi ende nuk kanë përfunduar procedurat e privatizimit të objektit, të filluara ndërmjet tyre që prej vitit 1996. Në këtë gjykim ka bërë kërkesë për ndërhyrje kryesore Drejtoria e Privatizimit të Ndërmarrjeve të Vogla e të Mesme pranë Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës.

4. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan, me vendimin nr. 2266, datë 27.11.2007, ka vendosur pranimin e kërkesëpadisë, ndryshimin e vendimit nr. 224/4 prot., datë 17.6.1996 të KKKP-së Elbasan, duke anuluar këtë vendim në pjesën që u jep trashëgimtarëve të z. Hysen Abdihoxha të drejtën e parablerjes për objektin librari.

5. Gjykata e Apelit Durrës, në bazë të ankimit të kërkuases, me vendimin nr. 10-2009-1031 (503), datë 8.12.2009, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. 2266, datë 27.11.2007 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan.

6. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2012-820, datë 12.4.2012, ka vendosur në dhomë këshillimi, mospranimin e rekursit të ushtruar nga kërkuësja, pasi nuk përmban shkaqe nga ato që parashikon neni 472 i KPC-së.

7. Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, me vendimin nr. 15, datë 19.4.2013, ka vendosur: pranimin pjesërisht të kërkesës, shfuqizimin e vendimit nr. 00-2012-820, datë 12.4.2012 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë dhe dërgimin e çështjes për rishqyrtim në Gjykatën e Lartë.



8. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 80, datë 10.3.2016, në seancë gjyqësore, ka lënë në fuqi vendimin nr. 503, datë 8.12.2009 të Gjykatës së Apelit Durrës.

II

9. **Kërkuesja Pranvera Duhaxhi** i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (Gjykata) me kërkesë sipas objektit, duke parashtruar këto shkaqe në mënyrë të përmbledhur:

9.1 Gjykata e Lartë ka anashkaluar përfundimet e arsyetuara nga Gjykata Kushtetuese. Sipas Gjykatës Kushtetuese janë konstatuar shkelje të parimit të gjësë së gjykuar dhe sigurisë juridike nga gjykatat e zakonshme.

9.2 Gjykata Kushtetuese është shprehur qartë për parimin *res judicata*, duke cituar se nuk mund të anashkalohej fakti që ndodhemi para të njëjtit objekt padie dhe para të njëjtit shkak ligjor të gjykuar njëherë.

9.3 Pretendimet e Gjykatës Kushtetuese nuk mund të jenë objekt kontrolli nga Gjykata e Lartë. Zbatimi i detyrueshëm i vendimeve të Gjykatës Kushtetuese është detyrim kushtetues.

9.4 Vendimi i Gjykatës së Lartë nuk përmban kriteret e zakonshme të arsyetimit të vendimit.

10. **Subjekti i interesuar Eleni Panganika** ka parashtruar në mënyrë të përmbledhur si më poshtë:

10.1 Referuar nenit 451/a të KPC-së elementet e gjësë së gjykuar kanë të bëjnë me të njëjtat palë në gjykim, të njëjtin objekt dhe të njëjtin shkak të padisë. Në mënyrë që të jemi para gjësë së gjykuar këto elemente duhet të jenë bashkërisht të pranishme, pasi mungesa qoftë edhe e njërit prej tyre do të sillte edhe mungesën e gjësë së gjykuar.

10.2 Nga shqyrtimi i çështjes në gjykatat e faktit ka rezultuar se në vendimin nr. 89, datë 21.5.2005 të Rrethit Gjyqësor Elbasan, me paditëse Pranvera Duhaxhiu, me të paditur KKPP-në dhe me objekt kundërshtimin e vendimit, e ndjera Nazmije Ferhati nuk ka qenë palë e këtij procesi. Ky vendim nuk mund të jetë i detyrueshëm për paditësen dhe për personat e tjerë që nuk kanë qenë pjesë e këtij procesi, ndaj nuk ndodhemi në kushtet e gjësë së gjykuar.

10.3 Gjykata e Lartë duke argumentuar qartë vendimin e saj nuk ka mënjeluar vendimin e formës së prerë të vitit 2005, përkundrazi ka

arsyetuar shkaqet përse nuk jemi para gjësë së gjykuar.

10.4 Në rastin konkret vendimi i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë është i rregullt në formë dhe i qartë në përmbajtje. Në tërësinë e tij ai krijon unitet, në të cilin pjesët përbërëse janë të lidhura ngushtësisht mes tyre.

10.5 Nga aktekspertimi i ekspertëve ing. topogjeodezistë dhe provat e tjera të administruara në gjykim rezulton se prona për të cilën ka disponuar KKKP-ja me vendimin nr. 224/4, datë 17.6.2006 nuk ndodhet te objekti librari, por 6-7 m në veri të tij. Pra nuk ka mbivendosje, për rrjedhojë kjo pronë nuk zë asnjë m² në objektin librari (aktekspertimi, faqe 77–97 e dosjes).

III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimitimin e kërkeses

11. Gjykata vlerëson se kërkesja legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të neneve 131/f dhe 134/1/i të Kushtetutës dhe *ratione temporis*, pasi kërkesa është paraqitur në Gjykatën Kushtetuese brenda afatit të parashikuar nga ligji nr. 8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.

12. Në lidhje me legjitimitimin *ratione materiae*, Gjykata rithekson se kërkesja i është drejtuar edhe më parë asaj me pretendime për cenimin e së drejtës për një proces të rregullt ligjor, duke kundërshtuar disa nga vendimet të cilat janë sërish objekt i kërkesës në shqyrtim. Me vendimin nr. 15, datë 19.4.2013, Gjykata vendosi pranimin pjesërisht të kërkesës, duke shfuqizuar vendimin nr. 00-2012-820, datë 12.4.2012 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë dhe dërgimin e çështjes për rishqyrtim në po atë gjykatë për shkak të cenimit të standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor. Gjykata vlerësoi se “vendimi i mospranimit të rekursit i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, objekt shqyrtimi, nuk ka respektuar standardin kushtetues të arsyetimit të vendimeve gjyqësore, si për faktin se nuk ka mbajtur qëndrim lidhur me pretendimin e kërkeses për cenimin e parimit të sigurisë juridike (shih paragrafët 10–13 të këtij vendimi), ashtu edhe për shkak të mungesës në përmbajtjen e tij të shkaqeve të parashtruara në rekurs (shih paragrafët 21–23 të këtij vendimi)”.



13. Në lidhje me pretendimet e tjera të ngritura në atë kërkesë Gjykata, gjithashtu, ka mbajtur një qëndrim të shprehur në vendimin e sipërcituar.

14. Gjykata ka vlerësuar se pretendimet e kërkuases se gjykatat e juridiksionit të zakonshëm kanë shkelur normat procedurale, se është cenuar parimi i paanshmërisë nga ana e gjykatave të zakonshme, se është shkelur parimi i ligjshmërisë në marrjen e provave dhe për ndërgjyqësinë, kanë të bëjnë me zbatimin e ligjit nga ana e këtyre gjykatave. Për rrjedhojë, Gjykata ka çmuar se këto pretendime nuk hyjnë në juridiksionin kushtetues, përderisa kërkesja nuk ka përcaktuar se cilat standarde kushtetuese janë cenuar.

B. Për pretendimin e cenimit të parimit të sigurisë juridike dhe të arsytimit të vendimit nga Gjykata e Lartë

15. Kërkesja pretendon se pas kthimit të çështjes për rishqyrtim në Gjykatën e Lartë vendimi i kësaj të fundit ka anashkaluar përfundimet e arsyetuara nga Gjykata Kushtetuese, e cila ka konstatuar shkelje të parimit të gjësë së gjykuar dhe sigurisë juridike nga gjykatat e zakonshme. Sipas kërkuases zbatimi i detyrueshëm i vendimeve të saj është detyrim kushtetues.

16. Gjykata Kushtetuese rithekson se referuar natyrës së gjykimit kushtetues të kërkesave individuale, kontrolli i respektimit të standardeve kushtetuese për një proces të rregullt ligjor është funksion edhe i gjykatave të zakonshme, për më tepër i Gjykatës së Lartë. Ky raport midis juridiksionit kushtetues dhe juridiksionit të gjykatave të zakonshme, kur është rasti i shqyrtimit nga ana e Gjykatës Kushtetuese të kërkesave individuale, në bazë të nenit 131/f të Kushtetutës, udhëhiqet nga parimi i subsidiaritetit (komplementaritetit) (*shih vendimin nr. 52, datë 2.12.2013 të Gjykatës Kushtetuese*).

17. Gjykata rithekson se zbatimi i detyrueshëm i vendimeve të saj është i garantuar nga Kushtetuta, e cila në nenet 132 dhe 145 të saj sanksionon shprehimisht këtë koncept kushtetues. Vendimet e Gjykatës kanë fuqi detyruese të përgjithshme dhe janë përfundimtare. Ato përbëjnë jurisprudencë kushtetuese dhe, për rrjedhojë, kanë efektet e forcës së ligjit. Ky efekt detyrues ka të bëjë si me pjesën urdhëruese, ashtu edhe me pjesën

arsyetuese të vendimit. Në respekt të doktrinës dhe të jurisprudencës kushtetuese, Gjykata ka theksuar se efekti detyrues që pasqyrohet mbi argumentet thelbësore të vendimit të saj përbën edhe një *ratio decidendi*, eliminimi i të cilave do ta bënte vendimin, në tërësinë e tij, të pakuptimtë. Nga kjo pikëpamje Gjykata ka theksuar se nga standardi i detyrimit të zbatimit të vendimmarrjes kushtetuese nuk mund të bëjë përjashtim as vet Gjykata Kushtetuese (*shih vendimin nr. 44, datë 29.6.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

18. Kërkesja edhe në kërkesën e parë drejtuar Gjykatës Kushtetuese, edhe në kërkesën objekt shqyrtimi pretendon se gjykatat e juridiksionit të zakonshëm, me vendimet për të cilat kërkohet shfuqizimi, duke anuluar pjesën e vendimit nr. 224/4 prot., datë 17.6.1996 të KKKP-së Elbasan, që u jep trashëgimtarëve të z. Hysen Abdihoxha të drejtën e parablerjes për objektin librari, kur të privatizohet, nuk kanë mbajtur parasysh vendimin e formës së prerë nr. 89, datë 21.5.2005 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, i cili u ka njohur atyre (trashëgimtarëve) këtë të drejtë (të parablerjes), duke cenuar në këtë mënyrë parimin e gjësë së gjykuar (*res judicata*).

19. Në vendimin e saj të datës 15, datë 19.4.2013 Gjykata Kushtetuese në lidhje me parimin e gjësë së gjykuar është shprehur se “*edhe pse nuk ndodhemi në kushtet e kuptimit klasik të “gjësë së gjykuar”, meqenëse vendimi nr. 89, datë 21.5.2005 ka palë ndërgjyqëse të ndryshme nga ato të vendimeve të kundërshtuara, nuk mund të anashkalohet fakti që ndodhemi para të njëjtit objekt padie dhe para të njëjtit shkak ligjor të gjykuar njëherë*”. Më tej Gjykata Kushtetuese ka vlerësuar se “*Gjykata e Lartë duhet të mbante një qëndrim të shprehur lidhur me pretendimin e kërkuases për cenimin e parimit të sigurisë juridike*”.

20. Pas kthimit të çështjes për rishqyrtim nga Gjykata Kushtetuese, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 80, datë 10.3.2016, ka lënë në fuqi vendimin nr. 503, datë 8.12.2009 të Gjykatës së Apelit Durrës, duke argumentuar: “*Në lidhje me pretendimin palës së paditur se, gjykata ka gjykuar një çështje civile që është gjykuar njëherë për të njëjtin shkak dhe objekt gjykimi dhe kjo është zgjidhur me vendim të formës së prerë, ky Kolegj e konsideron këtë pretendim të pabazuar. Nga shqyrtimi i çështjes në gjykatat e faktit ka rezultuar se, në vendimin nr. 89, datë 21.5.2005 të Gjykatës së Shkallës së Parë*



Elbasan, me paditës Pranvera Dubanxhiu me të paditur K.K.P.Pronave me objekt kundërshtim vendimi rezulton që, e ndjera Nazmije Ferhati të mos ketë qenë palë e këtij procesi. Ky vendim nuk mund të jetë i detyrueshëm për paditësen dhe për personat e tjerë që nuk kanë qenë pjesë e këtij procesi, ndaj nuk ndodhemi në kushtet e gjësë së gjykuar.

Referuar nenit 451/a të KPC, elementet e gjësë së gjykuar kanë të bëjnë me të njëjtat palë në gjykim, të njëjtin objekt dhe të njëjtin shkak të padisë. Në mënyrë që të jemi para gjësë së gjykuar këta elementë duhet të jenë bashkërisht të pranishëm, pasi mungesa qoftë dhe e njërit prej tyre do të sillte edhe mungesën e gjësë së gjykuar.

Po sipas Gjykatës së Lartë “nga shqyrtimi i çështjes në gjykatat e faktit ka rezultuar se, në vendimin nr. 89, datë 21.5.2005 të Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan, me paditës Pranvera Dubanxhiu me të paditur KKPP me objekt kundërshtim vendimi rezulton që, e ndjera Nazmije Ferhati të mos ketë qenë palë e këtij procesi. Ky vendim nuk mund të jetë i detyrueshëm për paditësen dhe për personat e tjerë që nuk kanë qenë pjesë e këtij procesi, ndaj nuk ndodhemi në kushtet e gjësë së gjykuar. Në interpretim dhe zbatim të ligjit, vendimi gjyqësor i formës së prerë që e ka zgjdhur çështjen në themel, përbën një zgjdhje të natyrës përfundimtare dhe të qëndrueshme të mosmarrëveshjes si në kuptimin konstitutiv, ashtu dhe atë prekluziv. Në kuptimin konstitutiv ai jep zgjdhjen përfundimtare të mosmarrëveshjes, pozitive të palëve të kundërta në atë gjykim, ndërsa në kuptimin prekluziv ndalohet mundësia e kërimit në gjykatë të ndryshimeve në zgjdhjen e mosmarrëveshjes së përvaktuar me vendimin gjyqësor të formës së prerë. Pra autoriteti dhe efektet e gjësë së gjykuar janë përfundimi i procesit civil dhe pamundësia e të njëjtave palë ndërgjyqëse për t'i kërkuar gjykatës që të shqyrtojë dhe vendosë përsëri mbi të njëjtin objekt gjykimi (res iudicata est).”

21. Duke vlerësuar zbatimin e standardeve të mësipërme gjatë shqyrtimit të çështjes konkrete, Gjykata konstaton se Gjykata e Lartë i ka përmbushur detyrimet që rrjedhin nga vendimi nr. 15, datë 19.4.2013 për të zhvilluar një proces të rregullt ligjor gjatë rishqyrtimit të çështjes në po atë gjykatë. Në zbatim të vendimit detyrues të Gjykatës, Gjykata e Lartë, në përputhje me kompetencat e saj ligjore, pasi ka marrë në shqyrtim pretendimet e ngritura në rekurs, duke kaluar çështjen për shqyrtim në seancë gjyqësore, ka vlerësuar se vendimi nr. 503, datë 8.12.2009 i Gjykatës së Apelit Durrës është i drejtë dhe për këtë arsye e ka lënë në fuqi atë.

22. Gjykata ripohon se e drejta për një proces të rregullt ligjor, që i garantohet individit nga nenet 42 dhe 142/1 të Kushtetutës dhe neni 6 i KEDNJ-së, përfshin edhe të drejtën për të pasur një vendim gjyqësor të arsyetuar.

23. Në rastin konkret, Gjykata vlerëson se pretendimet e kërkuases kanë të bëjnë me çështje të natyrës ligjore dhe si të tilla i takojnë për zgjdhje gjykatave të zakonshme. Veçanërisht vendimi i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, ku ngrihen pretendimet për cenim të parimit të arsytimit të vendimit, në pjesën e tij hyrëse përmban palët ndërgjyqëse, objektin e padisë, disponimet e gjykatave më të ulëta dhe shkaqet e rekursit të paraqitur nga pala e paditur në proces. Vendimi përmban edhe vlerësimin e Gjykatës së Lartë në lidhje me shkaqet e rekursit, si dhe argumentet që e kanë çuar atë në qëndrimin e shprehur në dispozitiv. Në këtë kuptim, Gjykata çmon se vendimi i kundërshtuar nuk rezulton të jetë jologjik, të ketë kundërthënie, të mos ketë referencë në ligjin e zbatueshëm dhe të mos respektojë elementet e përmendura më sipër, duke përmbushur në mënyrë të mjaftueshme detyrimin për arsytimin e vendimit objekt shqyrtimi. Gjykata e Lartë, për shkak të pozicionit dhe rolit të saj si gjykatë ligji, shqyrton rekursin për pretendime të shkeljes së ligjit material ose procedural, gjë që përbën funksionin kryesor të saj. Ajo analizon çështjen në drejtim të kontrollit të ligjshmërisë dhe bazueshmërisë së vendimeve të ankmuara. Në zbatim të parimit të subsidiaritetit, kontrolli i respektimit të standardeve kushtetuese për një proces të rregullt ligjor është funksion edhe i gjykatave të zakonshme, për më tepër i Gjykatës së Lartë. Raporti ndërmjet juridiksionit kushtetues dhe juridiksionit të gjykatave të zakonshme, kur është rasti i shqyrtimit nga ana e kësaj Gjykate i kërkesave individuale, në bazë të nenit 131/f të Kushtetutës, udhëhiqet nga parimi i subsidiaritetit (komplementaritetit). Një qëndrim i ndryshëm do ta kthente Gjykatën Kushtetuese në një instancë të zakonshme, gjë që nuk është funksioni i saj (shih vendime nr. 42, datë 7.7.2014; nr. 62, datë 23.9.2015; nr. 37, datë 30.6.2016 të Gjykatës Kushtetuese).

24. Bazuar në sa më sipër, Gjykata arrin në përfundimin se pretendimi i kërkuases për cenimin e standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor është i pabazuar.



25. Po ashtu, në vlerësimin e Gjykatës arsyetimi i vendimit nr. 00-2016-726(80), datë 10.3.2016 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë nuk paraqet ndonjë mangësi, e cila mund të ndikojë në cenimin e së drejtës për një proces të rregullt ligjor. Ky vendim është i qartë në interpretimin dhe zbatimin e ligjit, si dhe lidhur me faktet që janë konsideruar të provuara.

26. Gjykata çmon se dhe pretendimi për cenimin e parimit të sigurisë juridike në rastin konkret lidhet me mënyrën e interpretimit dhe zbatimit të ligjit nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm, dhe si i tillë nuk hyn në juridiksionin kushtetues.

27. Në përfundim, Gjykata vlerëson se pretendimet e kërkuases për cenimin e së drejtës për një proces të rregullt ligjor, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës, janë të papabazuara.²

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 131/f dhe 134/1/i të Kushtetutës, si dhe të neneve 72, 77 e vijues të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

VENDOSI:

- Rrëzimin e kërkesës.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë pro: Bashkim Dedja (kryetar), Vitore Tusha, Gani Dizdari, Besnik Imeraj, Fatos Lulo

Anëtarë kundër: Fatmir Hoxha

Anëtarë pjesërisht kundër: Vladimir Kristo

MENDIM PAKICE

1. Shumica ka vendosur rrëzimin e kërkesës së shtetases Pranvera Duhaxhiu. Nuk pajtohem me vendimin e shumicës për arsyet si më poshtë.

2. Nga rrethanat e çështjes, sikurse konstaton edhe shumica, rezulton se çështja është shqyrtuar edhe një herë nga kjo Gjykatë (*vendimi nr. 15, datë*

19.4.2013 i Gjykatës Kushtetuese) dhe pas kthimit të çështjes për rigjykim në Gjykatën e Lartë, kjo e fundit, me vendimin nr. 80, datë 10.3.2016, në seancë gjyqësore, ka lënë në fuqi vendimin nr. 503, datë 8.12.2009 të Gjykatës së Apelit Durrës. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë në lidhje me pretendimin e kërkuases se çështja është gjykuar njëherë për të njëjtin shkak dhe objekt gjykimi dhe është zgjidhur me vendim të formës së prerë, ka argumentuar se “*nga shqyrtimi i çështjes në gjykatat e faktit ka rezultuar se në vendimin nr. 89, datë 21.5.2005 të Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan, me paditës Pranvera Duhaxhiu me të paditur K.K.P.Pronave me objekt kundërshtim vendimi rezulton që, e ndjera Nazmije Ferhati të mos ketë qenë palë e këtij procesi. Ky vendim nuk mund të jetë i detyrueshëm për paditësen dhe për personat e tjerë që nuk kanë qenë pjesë e këtij procesi, ndaj nuk ndodhemi në kushtet e gjësë së gjykuar. Referuar nenit 451/a të KPC, elementet e gjësë së gjykuar kanë të bëjnë me të njëjtat palë në gjykim, të njëjtin objekt dhe të njëjtin shkak të padisë. Në mënyrë që të jemi para gjësë së gjykuar këta elementë dubet të jenë bashkërisht të pranishëm, pasi mungesa qoftë dhe e njërit prej tyre do të sillte edhe mungesën e gjësë së gjykuar” (shih paragrafin nr. 20 të vendimit të shumicës).*

3. Në këto kushte, kërkuessa i është drejtuar përsëri kësaj Gjykate duke pretenduar cenimin e parimit të sigurisë juridike dhe të standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor.

4. Shumica i ka analizuar pretendimet e kërkuases në këndvështrim të respektimit të parimeve të lartpërmendura dhe ka konstatuar se Gjykata e Lartë i ka përmbushur detyrimet që rrjedhin nga vendimi nr. 15, datë 19.4.2013 i kësaj Gjykate për të zhvilluar një proces të rregullt ligjor gjatë rishqyrtimit të çështjes. Sipas shumicës, në zbatim të vendimit detyruar të Gjykatës, Gjykata e Lartë, në përputhje me kompetencat e saj ligjore, pasi ka marrë në shqyrtim pretendimet e ngritura në rekurs, duke kaluar çështjen për shqyrtim në seancë gjyqësore, ka vlerësuar se vendimi nr. 503, datë 8.12.2009 i Gjykatës së Apelit Durrës është i drejtë dhe për këtë arsye e ka lënë në fuqi atë (*shih paragrafin nr. 21 të vendimit*). Konkretisht, shumica ka çmuar se pretendimi për cenimin e parimit të sigurisë juridike në rastin konkret lidhet me mënyrën e interpretimit dhe të zbatimit të ligjit nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm, dhe si i tillë nuk hyn në juridiksionin kushtetues (*shih paragrafin nr. 26 të vendimit*) dhe se vendimi i kundërshtuar nuk

² Gjyqtari F. Hoxha u shpreh për pranimin e kërkesës, sipas qëndrimit të mbajtur në Mendimin Paralel të vendimit nr. 15, datë 19.4.2013 të Gjykatës Kushtetuese.



rezulton të jetë jologjik, të ketë kundërthënie, të mos ketë referencë në ligjin e zbatueshëm dhe të mos respektojë elementet e përmendura më sipër, duke përbushur në mënyrë të mjaftueshme detyrimin për arsyetimin e vendimit objekt shqyrtimi (*shih paragrafin nr. 23 të vendimit*).

5. Në ndryshim nga shumica jam i mendimit se Gjykata e Lartë vetëm formalisht ka respektuar vendimin e Gjykatës Kushtetuese dhe detyrimet që rrjedhin prej këtij vendimi. Sikurse jam shprehur në mendimin paralel të vendimit nr. 15, datë 19.4.2013 të kësaj Gjykate, në thelb, vendimet e gjykatave të zakonshme objekt shqyrtimi disponojnë mbi një gjë të gjykuar, që është e drejta e parablerjes, e cila i është njohur kërkueses me vendimin gjyqësor të formës së prerë nr. 89, datë 21.5.2005 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan. Ky qëndrim është pohuar edhe nga shumica në vendimin nr. 15, datë 19.4.2013 të kësaj Gjykate kur arsyeton se *vendimi nr. 89, datë 21.5.2005 ka palë ndërgjyqëse të ndryshme nga ato të vendimeve të kundërshtuara dhe nuk mund të anashkalohet fakti që ndodhemi para të njëjtit objekt padie dhe para të njëjtit shkak ligjor të gjykuar njëherë* (*shih paragrafin nr. 19 të vendimit*). Pra, me fjalë të tjera, vendimet gjyqësore objekt kundërshtimi dhe vendimi i formës së prerë në thelb kanë objekt dhe shkak ligjor të njëjtë.

6. Sipas jurisprudencës kushtetuese parimi i gjësë së gjykuar përfshin jo vetëm urdhërimet e dispozitivit të vendimit gjyqësor, por edhe zbatimin e së drejtës së përcaktuar në pjesën përshkruese arsyetuese të vendimit, me kusht që ato të jenë kryer me qëllim dhënien e vendimit gjyqësor dhe t'u përkasin fakteve ose marrëdhënieve që kanë formuar objektin e gjykimit mbi të cilin gjykata ka dhënë vendimin e saj (*shih vendimin nr. 36, datë 25.7.2013 të Gjykatës Kushtetuese*).

7. Në këtë drejtim Gjykata ka theksuar se dhënia e vendimeve të ndryshme gjyqësore për çështje të njëjta bie ndesh me parimin e sigurisë juridike në praktikën gjyqësore. Parimi i sigurisë juridike nënkupton, ndërmjet të tjerash, garantimin e besueshmërisë së individit të shteti, institucionet e tij dhe tek aktet që ato nxjerrin. Ndërsa në rastin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë siguria juridike nënkupton se nëse gjykata ka vendosur përfundimisht për një çështje, vendimi i saj nuk duhet të vihet në dyshim. Pra, kur vendimi ka marrë formë të prerë ai është i detyrueshëm për palët, trashëgimtarët e tyre, për personat që

tërheqin të drejta nga palët, për gjykatën që ka dhënë vendimin dhe për të gjitha gjykatat dhe institucionet e tjera. Vendimi gjyqësor i formës së prerë, që përbën gjë të gjykuar, është shprehje dhe konkretizim i së drejtës mbi marrëdhënien juridike dhe ka qëllim t'i japë jo vetëm qartësi, por edhe siguri kësaj marrëdhënieje (*shih vendimin nr. 21, datë 16.4.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

8. Të njëjtin qëndrim ka mbajtur edhe Gjykata Europiane për të Drejtat e Njeriut, e cila ka nënvizuar se “...në pikëpamjen e Gjykatës, parimi në bazë të të cilit një vendim përfundimtar i formës së prerë është gjë e gjykuar dhe zgjidh mosmarrëveshjen midis palëve me një efekt përfundimtar është një element themelor i së drejtës për një gjykim të drejtë, që garantohet nga neni 6 i Konventës në çështjet civile. Parimi i sigurisë juridike dikton që kur një mosmarrëveshje civile është shqyrtuar në themel nga gjykata, vendimi i saj nuk vihet më në diskutim” (*shih çështjen Kehaya dhe të tjerë kundër Bullgarisë, datë 12.1.2006*). Kjo Gjykatë në disa çështje kundër Shqipërisë ka evidentuar rëndësinë e sigurisë juridike në procesin e kthimit dhe të kompensimit të pronave, veçanërisht për sa u përket të drejtave të fituara nga vendimet që kanë njohur të drejta pronësie dhe të ruajtjes së garancive që lidhen me këto të drejta (*shih Ramadhi dhe të tjerë kundër Shqipërisë, datë 13.11.2007; Hamzaraj kundër Shqipërisë, datë 3.2.2009; Manushaqe Puto dhe të tjerë kundër Shqipërisë, datë 31.7.2012*).

9. Në çështjen konkrete konstatoj se shumica duke arsyetuar se mënyra e interpretimit dhe zbatimit të ligjit nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm nuk hyn në juridiksionin kushtetues (gjë që në parim në kontekstin e duhur është e drejtë), ka rënë në “kurthin” e këtyre gjykatave. Ajo e ka mbështetur vendimin e saj, njësoj si Gjykata e Lartë, në një dispozitë ligjore të Kodit të Procedurës Civile (neni 451/a), ndërkohë që “gjëja e gjykuar”, si pjesë përbërëse e rëndësishme e parimit të sigurisë juridike dhe shtetit të së drejtës, duhet të përbënte pikënisjen e arsyetimit dhe vendimmarrjes së saj lidhur me problemin themelor të shtruar për zgjidhje në këtë çështje, faktin se në të gjitha nivelet e gjykimit kërkueses i është njohur e drejta e parablerjes e pronës objekt konflikti me vendim të formës së prerë.

10. Në vijim të arsyetimit dhe standardeve të mësipërme, duke qenë se Gjykata e Lartë në



rishqyrtimin e çështjes ka anashkalluar jo vetëm jurisprudencën e GJEDNJ-së për çështje të ngjashme, por edhe orientimet e dhëna në vendimin e mëparshëm të kësaj Gjykate, vlerësoj se në përmbushje të standardit kushtetues mbi forcën detyruese të vendimeve të Gjykatës Kushtetuese, ishte detyrë e kësaj të fundit t'i jepte përgjigje pretendimit nëse kërkueses i është cenuar ose jo nga vendimmarrja e gjykatave të zakonshme parimi i sigurisë juridike.

11. Në të kundërt, një vendim formal si ai i shumicës e kthen këtë Gjykatë në një shkallë të katërt të gjyqësorit, pasi nuk u jep përgjigje përfundimtare pretendimeve me natyrë kushtetuese që hyjnë në kompetencën e saj.

Anëtar: Vladimir Kristo

VENDIM

Nr. 16, datë 1.3.2017

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Bashkim Dedja kryetar	i	Gjykatës Kushtetuese
Vladimir Kristo	anëtar	i “ “
Vitore Tusha	anëtare	e “ “
Fatmir Hoxha	anëtar	i “ “
Gani Dizdari	anëtar	i “ “
Fatos Lulo	anëtar	i “ “
Besnik Imeraj	anëtar	i “ “

me sekretare Edmira Babaj, në datën 6.10.2016 mori në shqyrtim në seancë plenare, me dyer të hapura, çështjen me nr. 54/3 Akti, që i përket:

KËRKUESE: Shoqata për Mbrojtjen e Tregtarëve dhe të Tregut, përfaqësuar në gjykim nga z. Nikollaq Neranxi dhe z. Boiken Bendo, me autorizim.

Dhoma e Tregtisë dhe Industrisë, në mungesë.

SUBJEKTE TË INTERESUARA: Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar në gjykim nga znj. Ervina Domi, me autorizim.

Këshilli i Ministrave, përfaqësuar në gjykim nga znj. Lorana Kasapi dhe znj. Enkelejda Pipa, me autorizim.

OBJEKTI: Shfuqizimi si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë i ligjit nr.

142/2015 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, të ndryshuar.

Pezullimi i zbatimit të ligjit deri në hyrjen në fuqi të vendimit të Gjykatës Kushtetuese.

BAZA LIGJORE: Nenet 11, 17, 41, 84, 117, 118, 131/a, 134/1/f, 134/2 dhe 155 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; neni 1 i Protokollit nr. 1 të Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut; ligji nr. 8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Besnik Imeraj, përfaqësuesit e kërkueses, Shoqatës për Mbrojtjen e Tregtarëve dhe të Tregut, të cilët kërkuan pranimin e kërkesës, përfaqësuesit e subjekteve të interesuara, Kuvendit të Republikës së Shqipërisë dhe Këshillit të Ministrave, të cilët kërkuan rrëzimin e kërkesës, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

1. Kuvendi i Republikës së Shqipërisë (*Kuvendi*) ka miratuar ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i cili ka si objekt të tij taksat e bashkive dhe të komunave dhe si qëllim përcaktimin e rregullave për mënyrën e ushtrimit të të drejtave dhe të detyrave nga organet e qeverisjes vendore për vendosjen e taksave vendore, mbledhjen dhe administrimin e tyre.

2. Ligji nr. 142/2015, datë 17.12.2015 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, të ndryshuar”, i cili është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 252, datë 22 janar 2016, ka sjellë disa ndryshime në ligjin e mësipërm, dhe më konkretisht: në nenin 4 të tij (i cili ndryshon nenin 9 të ligjit nr. 9632/2006) është parashikuar përfshija në taksën mbi pasurinë e paluajtshme edhe e taksës mbi truallin; me nenin 5 (i cili ndryshon nenin 11 të ligjit nr. 9632/2006) është ndryshuar shkalla tatimore e aplikueshme mbi fitimin e tatueshëm; me nenin 8 (i cili ndryshon nenin 20 të ligjit nr. 9632/2006) janë parashikuar si subjekte që i nënshtrohen taksës mbi pasurinë



e paluajtshme edhe përdoruesit e pasurisë që nuk janë të pajisur me dokument pronësie; me nenin 9 (i cili ndryshon nenin 21/2 të ligjit nr. 9632/2006) janë përcaktuar kategoritë minimale të bazës së taksës dhe nivelet treguese të taksës; me nenin 12 (i cili shton nenin 23/1 në ligjin nr. 9632/2006) është parashikuar taksa për truallin si mënyra e caktimit të nivelit të kësaj takse; me nenin 14 (i cili ndryshon nenin 27 të ligjit nr. 9632/2006) është përcaktuar taksa e ndikimit në infrastrukturë dhe mënyra e caktimit të nivelit të saj; në nenin 15 (i cili ndryshon nenin 32 të ligjit nr. 9632/2006) përcaktohet se këshilli bashkiak cakton bazën dhe nivelin e taksës së tabelës etj. Bashkëlidhur ligjit janë edhe anekset shoqëruese të tij, sipas nenit 17, që parashikojnë nivelet treguese për secilën takse vendore sipas bashkive, zonave apo kategorive.

3. Me kërkesën e datës 4.5.2016, Shoqata për Mbrojtjen e Tregtarëve dhe të Tregut i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) për shfuqizimin e ligjit nr. 142/2015, duke pretenduar si ai është i papajtueshëm me Kushtetutën.

4. Me kërkesën e datës 18.7.2016, Dhoma e Tregtisë dhe Industrisë i është drejtuar Gjykatës me të njëjtin objekt dhe në thelb edhe për të njëjtat shkaqe.

5. Për këto arsye, Mbledhja e Gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese, në bazë të nenit 31 të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë” (*ligji nr. 8577/2000*), pasi mori në shqyrtim paraprak të dyja kërkesat e sipërcituara, vendosi bashkimin e çështjeve dhe shqyrtimin e tyre në një çështje të vetme.

II

6. **Kërkuesja, Shoqata për Mbrojtjen e Tregtarëve dhe të Tregut**, në mënyrë të përmbledhur ka parashtruar këto argumente përpara Gjykatës:

6.1 Shoqata ka interes të drejtpërdrejtë në paraqitjen e kërkesës para juridiksionit kushtetues për shqyrtimin e pajtueshmërisë me Kushtetutën të neneve objekt kundërshtimi, për rrjedhojë legjitimohet *ratione materiae* në kërkimet e saj.

6.2 Gjatë procedurës së hyrjes në fuqi të ligjit janë shkelur nenet 84, 117 dhe 155 të Kushtetutës. Edhe pse ligji nr. 142/2015 është

botuar në Fletoren Zyrtare të datës 22 janar 2016, në nenin 18 të tij është parashikuar se ai hyn në fuqi në datën 1 janar 2016, ndërkohë që sipas nenit 84/3 të Kushtetutës ligji hyn në fuqi 15 ditë nga botimi në Fletoren Zyrtare. Po ashtu, neni 155 i Kushtetutës përcakton një klauzolë imperative duke parashikuar në mënyrë eksplicite se në rastet e taksave, tatimeve dhe detyrimeve financiare kombëtare e vendore ligjit nuk mund t’i jepet fuqi prapavepruese. Në rastin konkret nuk ndodhemi përballë ndonjë situatë të jashtëzakonshme apo rast nevojë a urgjence që do të justifikonte hyrjen e menjëhershme në fuqi të tij në kuptim të nenit 84/4 të Kushtetutës.

6.3 Ligji i kundërshtuar bie ndesh me nenin 41 të Kushtetutës dhe nenin 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së. Nivelet e reja të taksave vendore në thelb çojnë në pakësim të pasurisë, duke sjellë kufizim të së drejtës së pronës. Dispozitat e këtij ligji cenojnë thelbin e të drejtave të taksapaguesve për të gëzuar qetësisht pasurinë e tyre.

6.4 Përmbajtja e dispozitave të ligjit të kundërshtuar kufizon nismën e lirë dhe të drejtën e pronës.

6.5 Nëpërmjet nenit 8 të ligjit është shtuar si kategori e re “taksa mbi truallin”, ndërkohë që në nenin 9 parashikohet rritja e kategorive minimale të “taksës për ndërtesën” 3 herë më shumë, rritja e taksës për zërin “tokë bujqësore” 1.4 herë më shumë, kurse rritja e taksës “fjetje në hotel”, e parashikuar në nenin 13 të ligjit, është 2.6 herë më shumë. Në nenin 14 të ligjit parashikohet një kategori e re e taksës, si dhe dyfishimi i kufijve për taksën e ndikimit në infrastrukturë në rastin e ndërtimeve për qëllime banimi apo njësi shërbimi nga shoqëritë e ndërtimit.

6.6 Rritja e taksave vendore është jo vetëm disproporcionale, në kundërshtim me nenin 17 të Kushtetutës, por vjen në kundërshtim të hapur edhe me parimin e aftësisë paguese, sipas nenit 155 të Kushtetutës. Bazuar në parimet makro-ekonomike, si dhe paketat fiskale, niveli i taksave duhet t’u përshtatet dhe t’u përafrohet sa më shumë treguesve të zhvillimit të vendit. Nëse ka rënie të treguesve makro-ekonomikë në masën 95% nuk mund të rritet niveli i tatim-taksave. Rritja e nivelit të taksave pa u marrë në konsideratë treguesit makro-ekonomikë sjell rritjen e mungesës së likuiditeteve për subjektet



tatimpaguese. Si një proces zinxhir, kjo e fundit ka efekte nga biznesi i vogël tek ai i madh. Referuar treguesve të QKR-së ka një frenim të kërkesave për regjistrim si person fizik dhe juridik nga janari 2016 deri në mars 2016. Po ashtu, referuar treguesve të Bankës së Shqipërisë, ka një ulje të ndjeshme të kërkesës së biznesit për kreditim.

6.7 Ligji i kundërshtuar cenon parimin e proporcionalitetit, pasi rritja e nivelit të taksave nuk shoqërohet me nevojën për kufizimin e garancive kushtetuese, kjo për faktin se asnjë e dhënë apo studim i kryer nuk tregon ndonjë lidhje të qenësishme dhe të drejtë midis masave të marra dhe rezultateve të dëshiruara. Për më tepër nuk ka asnjë balancim midis interesit që synohet të mbrohet dhe të drejtave të subjekteve që u kufizohen.

6.8 Ligjvënësi duhej të aplikonte rezervën ligjore relative të parashikuar në nenin 155 të Kushtetutës, si dhe kriteret për nxjerrjen e akteve nënligjore të sanksionuara në nenin 118 të Kushtetutës. Sipas ligjit në fuqi për taksat vendore përcaktimi i taksave vendore i është deleguar pushtetit vendor, por brenda kriterëve të përcaktuara në ligj. Në ligjin e kundërshtuar ligjvënësi nuk ka vendosur asnjë kriter për miratimin e taksave të reja, të cilat do të frenonin pushtetin vendor për të përcaktuar në mënyrë të menjëhershme nivelin maksimal të përcaktuar nga ligjvënësi, siç ka ndodhur konkretisht në Bashkinë e Tiranës, ku me vendimin nr. 59, datë 30.12.2015 të Këshillit Bashkiak për çdo taksë apo tarifë vendore janë aplikuar nivelet maksimale të niveleve të përcaktuara në ligj.

6.9. Nëse ligji nr. 142/2015 do të mbetet në fuqi, prodhimi i efekteve negative do të jetë i menjëhershëm dhe me pasoja të pariparueshme. Për rrjedhojë, deri në marrjen e një vendimi përfundimtar, duhet të vendoset pezullimi i zbatimit të ligjit të kundërshtuar, pasi plotësohen kërkesat e nenit 45 të ligjit organik të Gjykatës.

7. Kërkesja, Dhoma e Tregtisë dhe Industrisë, në mënyrë të përmbledhur ka parashtruar këto argumente para Gjykatës:

7.1 Kërkesja legjitimohet t'i drejtohet Gjykatës, pasi ka interes të drejtpërdrejtë në mbrojtjen e interesit të përgjithshëm të anëtarëve të saj, por edhe të gjithë komunitetit sipërmarrës dhe tregtar. Interesi real dhe i drejtpërdrejtë është rivendosja në kriteret e ligjshmërisë së plotë dhe

të baraspeshës funksionale mes interesit publik për mbledhjen e taksave dhe tatimeve, nga njëra anë, dhe interesit privat për sipërmarrjen e lirë dhe të pakufizuar, nga ana tjetër.

7.2 Ligji nr. 142/2015 është i papajtueshëm me Kushtetutën, pasi procedura e miratimit të tij bie ndesh me dy përcaktimet taksative të neneve 84 dhe 155 të Kushtetutës. Ky ligji ka hyrë në fuqi përpara botimit të tij në Fletoren Zyrtare. Cenimi i këtyre dispozitave ka prodhuar efekte të menjëhershme dhe reale, të materializuara në akte normative të organeve të qeverisjes vendore. Si shembull vlen të përmendet vendimi nr. 59 i Këshillit Bashkiak të Tiranës, i cili në datën 30.12.2015 ka miratuar taksat dhe tarifatat e reja për vitin 2016 bazuar pikërisht në ligjin e kundërshtuar.

7.3 Ndryshimi në bazën e taksës së ndikimit në infrastrukturë, sipas nenit 14/2 të ligjit nr. 142/2015, cenon në mënyrë të drejtpërdrejtë parimin e sanksionuar në nenin 11 të Kushtetutës për iniciativën e lirë ekonomike, pasi shteti shqiptar tashmë kufizon sipërmarrësit në një partneritet të detyrueshëm privat-publik, duke u bërë pjesë e pandarë e sipërmarrjes dhe e fitimit. Antikushtetutshmëria e dispozitës qëndron në faktin se çdo sipërmarrës duhet të jetë i qartë dhe i sigurt se bazuar në nenin 11 të Kushtetutës do të operojë një investim/sipërmarrje në një mjedis të sigurt ligjor dhe do të gjenerojë fitimet apo do të përballojë humbjet, por në çdo rast jo në një partneritet të imponuar me shtetin, ku ky i fundit përfiton vetëm benefitet e sipërmarrjes private.

7.4 Masat e marra për ndryshimin e nivelit të taksës së ndikimit në infrastrukturë nga 1-4% të vlerës së investimit në 4-8% të çmimit të shitjes sipas referencave përbën një ashpërsim të shpërpjesëtuar të masës kufizuese në favor të interesit publik, kufizim i cili nuk është i justifikuar. Sipas çdo mënyre përlllogaritjeje rezulton se taksa në fjalë është të paktën 10-fishuar, ndërkohë që sipas çdo lloj statistike zyrtare dhe publike, rritjet ekonomike përlllogariten në masat 0.2–0.3%. Kjo do të thotë se masa e taksës është dukshëm e ekzagjeruar dhe jo e përshtatshme për të justifikuar arritjen e qëllimit dhe objektivit për të cilin ajo është parashikuar.

8. Subjekti i interesuar, Kuvendi, ka parashtruar në mënyrë të përmbledhur sa më poshtë:



8.1 Në lidhje me pretendimin për antikushetueshmërinë formale të ligjit nr. 142/2015, ai është miratuar në Kuvend në datën 17.12.2015, pas një sërë diskutimesh dhe seancash dëgjimore me grupet e interesit. Ai ka qenë pjesë e ligjeve financiare që shoqëruan ligjin për buxhetin e shtetit dhe ndaj u caktua si datë e hyrjes në fuqi 1 janari 2016, pasi ishte parashikuar që ligjet pjesë e paketës fiskale të kishin impakt financiar në vitin 2016. Për shkak të mosushtrimit të së drejtës kushtetuese të Presidentit për shpalljen e tij, ai u shpall pas kalimit të afatit kushtetues 20-ditor. Për sa më sipër, përcaktimi për hyrjen në fuqi të këtij ligji në datën 1 janar 2016 është jo vetëm pasojë e nevojës për të sjellë impakt financiar të menjëhershëm për këtë vit, por edhe e një gabimi në përlllogaritjen e afateve të domosdoshme që vetë Kushtetuta parashikon për shpalljen dhe hyrjen në fuqi të një ligji. Kjo ka sjellë që për një periudhë 37-ditore, edhe pse nuk ka qenë vullneti i ligjvënësit, të krijohet *de facto*, në fazën e zbatimit të këtij ligji, premisa për dhënien fuqi prapavepruese atij. Megjithatë, në rastin konkret nuk kemi të bëjmë me dhënien e fuqisë prapavepruese ligjit, por përkundrazi me hyrjen në fuqi të tij, aspekt ky i parashikuar nga dispozitat kushtetuese, të cilat në rastin konkret duhet të zbatoheshin drejtpërdrejt prej organeve të shtetit që janë ngarkuar për zbatimin e ligjit objekt kërkesë.

8.2 Ky ligj vërtet ka krijuar detyrime të reja për këtë periudhë, por nga ana tjetër ka krijuar edhe lehtësi dhe privilegje për operatorët, pasi ka hequr dhe reduktuar një sërë detyrimesh për disa kategori. Po ashtu, subjektet kanë të drejtë të ankohen pranë vetë organit që zbaton ligjin, si edhe në organet gjyqësore për rregullimin e pasojave nga zbatimi i tij për periudhën 37-ditore. Ligji nr. 142/2015 është një nga ligjet më të rëndësishme financiare dhe shfuqizimi i tij do të krijonte vakuum ligjor dhe pamundësi për të siguruar të ardhurat e nevojshme për buxhetin e qeverisjes vendore, duke cenuar interesin publik dhe sigurinë juridike.

8.3 Ndryshimet e miratuara me ligjin nr. 142/2015 janë rezultat i një analize të plotë dhe të kujdesshme. Ky ligj ka mundësuar miratimin e një sërë normash rregulluese në aspektin procedural lidhur me administrimin e taksave vendore, ka përcaktuar apo vendosur taksa të reja, si dhe ka reduktuar apo shfuqizuar taksa ekzistuese. Ligji nr. 142/2015 është mjeti që ka kufizuar lirinë e veprimtarisë ekonomike të subjekteve nëpërmjet

vendosjes dhe përcaktimit të disa taksave, përfshirë taksën e ndikimit në infrastrukturë, por kufizimi plotëson kriteret kushtetuese pasi është i vendosur me ligj, është proporcional dhe justifikohet nga qëllimi i sistemit tatimor për mirëqenien e përgjithshme. Në këto kushte, në vlerësimin tonë, nuk ndodhemi në kushtet e cenimit të lirisë së veprimtarisë ekonomike.

8.4 I pabazuar është edhe pretendimi për cenimin e së drejtës së pronës private. Gjatë gjithë procesit të miratimit të ligjit objekt gjykimi janë respektuar parimet kushtetuese tashmë pjesë e jurisprudencës kushtetuese. Gjatë procesit të diskutimit të projektligjit në Komisionin e Ekonomisë, ky i fundit, bazuar në kërkesën e grupeve të interesit, ka zhvilluar një seancë dëgjimore me shoqatat e biznesit për projektligjet financiare që shoqëronin projektbuxhetin 2016. Në këtë seancë paraqitën mendime e propozime për projektligjin drejtuesit e Dhomës së Tregtisë dhe Industrisë Tiranë, që është edhe një prej kërkesve në këtë proces gjyqësor kushtetues, të Dhomës Amerikane të Tregtisë, të shoqatës “Biznes Albania” dhe të Shoqatës Shqiptare të Turizmit. Pasi u dëgjuan dhe u analizuan propozimet për ndryshime, Komisioni dhe më pas Kuvendi miratuan disa ndryshime me qëllim krijimin e balancës së duhur ndërmjet kufizimeve dhe lehtësirave. Nga Kuvendi është respektuar edhe parimi i eficiencës dhe efektivitetit, i cili kërkon mbi të gjitha gjetjen e zgjidhjeve të shpejta dhe rezultative. Në miratimin e këtij ligji është mbajtur parasysh edhe parimi i barazisë, i cili duhet të përshkojë çdo veprim të administratës fiskale qendrore apo lokale në një shtet të së drejtës.

8.5 Në lidhje me taksën e ndikimit në infrastrukturë, të parashikuar në nenin 14/2 të ligjit nr. 142/2015 (neni 27/2 i ligjit nr. 9632/2006), që ka qenë edhe dispozita më e kundërshtuar, Kuvendi ka miratuar një shtesë në ligjin bazë, masë që u bazuar në propozimin e Shoqatës së Bashkive, pasi u argumentua se vendosja e një tavanit të lartë për taksën fikse bën të mundur që të nxitet zhvillimi në zonat që kanë ndikim më të madh në zhvillimin ekonomik të vendit dhe të ngadalësohet ndërtimi në hapësira të mbindërtuara e të urbanizuara tej limiteve të mundshme infrastrukturore. Pra, kjo taksë ka një interes të rëndësishëm publik, që lidhet me



dendësinë e banorëve në infrastrukturën publike. Gjithashtu, interesi publik është joshterues, pasi realizimi i një buxheti të plotë nga vjelja e taksave dhe tatimeve ka impakt të shumanshëm publik, social dhe infrastrukturor dhe ky vlerësim sigurisht që nuk lidhet vetëm me taksën e ndikimit në infrastrukturë, por me të gjithë sistemin e taksimit të përcaktuar me këtë ligj.

8.6 Nga analiza e detajuar për disa prej taksave të trajtuara nga ligji nr. 142/2015 rezulton se disa janë hequr (tatimi i thjeshtuar mbi fitimin e biznesit të vogël për subjektet me qarkullim vjetor nën 5 milionë lekë), kurse disa të tjera janë reduktuar ndjeshëm (2.5% tatimi i thjeshtuar mbi fitimin e biznesit të vogël për subjektet me xhiro nga 5-8 milionë lekë, përgjysmim i taksës për ndërtesat, reduktim i taksës së fjetjes për qëllime turizmi). Përmes miratimit të ligjit nr. 142/2015, Kuvendi ka mundësuar një politikë tejet balancuese heqjeje dhe reduktimi taksash përkundrejt rritjes së ndonjë takse, siç është ajo e ndikimit në infrastrukturë.

8.7 Lidhur me kërkesën për pezullim nuk ka shkaqe të mjaftueshme ligjore që të çojnë në marrjen e kësaj mase.

9. **Subjekti i interesuar, Këshilli i Ministrave**, në mënyrë të përmbledhur ka parashtruar si më poshtë:

9.1 Kërkesesi nuk legjitimohet t'i drejtohet Gjykatës Kushtetuese, pasi bazuar në jurisprudencën e GJEDNJ-së mosmarrëveshjet e lindura në fushën e tatim-taksave bien jashtë fushëveprimit të të drejtave dhe detyrimeve civile, pavarësisht nga efektet në të holla që ato prodhojnë detyrimisht për tatimpaguesit.

9.2 Në lidhje me pretendimin për momentin e hyrjes në fuqi, shtrirja e efekteve të taksave sipas këtij ligji është deri më 31 dhjetor të vitit në vijim, kështu që hyrja në fuqi e tij në shkurt dhe shtrirja e efekteve që nga janari nuk e bën atë antikushtetues. Për efekt të të gjithë sistemit të përlogaritjes së taksave, viti ushtrimor merret si një i tërë. Ai fillon në datën 1 janar dhe përfundon në datën 31 dhjetor.

9.3 Në lidhje me pretendimin për taksën e truallit, shteti social nuk mund të ekzistojë në rast se nuk ka një balancë ndërmjet subjekteve private dhe qytetarëve të tjerë. Kur kjo balancë prishet në favor të kërkesit, shteti është i detyruar të

ndërhyjë. Për sa i takon taksës së fjetjes në hotel, ajo është përgjysmuar dhe përbën një ndër burimet e të ardhurave të pushtetit vendor. Destinacioni i këtyre të ardhurave mbetet në politikat e zhvillimit të qeverisjes vendore. Për sa i takon pretendimit për rritjen e taksës për tokën bujqësore me 1.4 herë, ky është një pretendim i pabazuar, pasi ligji nuk e ka ndryshuar këtë taksë, e cila llogaritet sipas aneksit 2 të tij. Në lidhje me pretendimin për rritjen e taksës së ndërtesës, e vërteta është se përgjysmohet taksa për ndërtesat që përdoren për veprimtari prodhuese, niveli i të cilave nga 400, 300 dhe 200 lekë/m² në vit, që është aktualisht, ulet në 200, 150 apo 100 lekë/m² në vit, në varësi të zonës përkatëse. Kurse në lidhje me taksën e ndikimit në infrastrukturë, ajo i shërben pushtetit vendor për kryerjen e investimeve në ato hapësira publike ku infrastruktura ka pësuar dëmtime si pasojë e ndërtimeve të reja. Propozimi i këtij saktësimi synon incentivimin e subjekteve ndërtuese për kthimin në gjendjen e mëparshme të infrastrukturës ku kanë kryer ndërtimin, duke ndihmuar në këtë mënyrë edhe pushtetin vendor duke i kursyer kohë, burime njerëzore dhe kosto. Në përcaktimin e ri që është bërë në lidhje me këtë taksë janë marrë për bazë edhe referencat e vendeve të rajonit.

9.4 Detyrimi për pagimin e tatimeve dhe taksave apo detyrimeve të tjera financiare, është detyrim i parashikuar nga neni 155 i Kushtetutës, i disiplinuar në ligje dhe akte të tjera nënligjore. Ky qëndrim referohet edhe në jurisprudencën e GJEDNJ-së, e cila i ka përjashtuar këto lloje ndërhyrjesh nga ato që do të përbënin shkak për shkelje të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së.

9.5 Në lidhje me kërkesën për pezullimin e zbatimit të ligjit objekt gjykimi, në rastin konkret nuk ndodhemi përpara cenimit të një interesi shtetëror, shoqëror, individual konkret dhe jo të hamendësuar, si kusht i vetëm për të vendosur pezullimin e zbatimit të aktit (neni 45 i ligjit nr. 8577/2000).

III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimitimin e kërkeses

10. Çështjen e legjitimitimit (*locus standi*) Gjykata e ka vlerësuar si një ndër aspektet kryesore që lidhen me inicimin e një procesi kushtetues. Në



gjykime të kontrollit të kushtetutshmërisë së normës, subjektet iniciuese, që parashikohen në nenin 134/2 të Kushtetutës, kanë detyrimin për të provuar lidhjen e domosdoshme që duhet të ekzistojë ndërmjet veprimtarisë ligjore që ato kryejnë dhe çështjes kushtetuese të ngritur. Shoqatat (organizatat) janë të specifikuar në nenin 134/1/h të Kushtetutës, si një ndër subjektet që ushtrojnë në mënyrë të kushtëzuar të drejtën për t'iu drejtuar Gjykatës, duke pasur legjitimitet kushtetues vetëm për çështjet që lidhen me interesat e tyre. Në kuptimin kushtetues dhe ligjor, shoqatat paraqiten si bashkime vullnetare të shtetasve mbi bazën e ideve, bindjeve, pikëpamjeve e interesave të përbashkët (*shih vendimin nr. 33, datë 8.6.2016 të Gjykatës Kushtetuese*).

11. Vlerësimi nëse një organizatë ka ose jo interes bëhet rast pas rasti, në varësi të rrethanave të çdo çështjeje të veçantë. Organizata që vë në lëvizje Gjykatën duhet të provojë se në çfarë mënyre ajo mund të preket në një aspekt të situatës së saj, pra duhet të provojë lidhjen e drejtpërdrejtë dhe të individualizuar që ekziston midis situatës së saj dhe normës që kundërshton. Interesi për të vepruar duhet të jetë i sigurt, i drejtpërdrejtë dhe vetjak. Ky interes konsiston tek e drejta e shkelur, te dëmi real ose potencial dhe jo te premiset teorike mbi antikushtetutshmërinë e normës që ka sjellë këtë cenim të interesit (*shih vendimet nr. 14, datë 21.3.2014; nr. 78, datë 22.12.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

12. Bazuar në standardet e mësipërme, Gjykata vlerëson se kërkesja, Shoqata për Mbrojtjen e Tregtarëve dhe të Tregut, legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të rregullimit të parashikuar nga neni 134/1/h i Kushtetutës dhe neni 49/ 3/d i ligjit nr. 8577/2000 të ndryshuar. Shoqata është një subjekt juridik me 12 anëtarë themelues, e regjistruar me vendimin nr. 162, datë 6.2.1998 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Anëtarë të saj janë tregtarë të vegjël ose të mëdhenj, me shumicë ose pakicë, pronarë restorantesh, kafesh, klubesh dhe fshatarë që tregtojnë dhe shesin prodhimet e tyre në treg. Për këto arsye, Gjykata vlerëson se kërkesja përfshihet në rrethin e subjekteve që mund t'i drejtohen asaj për kontrollin kushtetues të normës, pasi ajo është

krijuar si shoqatë dhe gëzon personalitet juridik në përputhje me kërkesat e ligjit. Kërkesja legjitimohet edhe *ratione temporis*, pasi kërkesa është paraqitur brenda afatit ligjor të përcaktuar në nenin 50 të ligjit nr. 8577/2000, të ndryshuar.

13. Në lidhje me legjitimitetin *ratione materiae*, sipas kërkesave të nenit 134/2 të Kushtetutës, kërkesja mund të bëjë kërkesë vetëm për çështje që lidhen me interesat e saj, për rrjedhojë ka detyrimin të provojë lidhjen e domosdoshme që ekziston ndërmjet misionit që ka dhe marrëdhënies juridike të cenuar nga dispozitat përkatëse të ligjit të kundërshtuar nr. 142/2015.

14. Gjykata vëren se sipas statutit të Shoqatës për Mbrojtjen e Tregtarëve dhe të Tregut qëllimi i krijimit të saj është mbrojtja e interesave të tregtarëve nga sfidat e ekonomisë së tregut për realizimin me sukses të qëllimit të biznesit të tyre, duke u specializuar vazhdimisht në njohjen, përdorimin e teknikës dhe parimet e ekonomisë së tregut për t'i shpëtuar konkurrencës së pandershme dhe falimentimit. Shoqata ka për qëllim të ndërhyjë pranë organeve shtetërore për të siguruar ekuilibrat e tregut, të mbrojtë interesat ligjorë të tregtarëve vendas ose të huaj, kur ata shkelen nga organet tatimore ose organe të tjera, si dhe të përfaqësojë ata në gjykime. Për sa u takon dispozitave të kundërshtuara nga kërkesja, ato synojnë rregullimin në përputhje me ligjin të veprimtarisë së taksapaguesve, në aspektin procedural lidhur me administrimin e taksave vendore, vendosin taksat të reja dhe reduktojnë apo shfuqizojnë taksat ekzistuese. Në këto kushte, Gjykata, bazuar në statutin, aktin e themelimit dhe natyrën e veprimtarisë së shoqatës kërkuese, vlerëson se provohet lidhja e drejtpërdrejtë midis veprimtarisë ligjore për të cilën ajo është krijuar dhe çështjes kushtetuese të pretenduar prej saj.

15. Sipas subjektit të interesuar, Këshillit të Ministrave, kërkesja nuk legjitimohet t'i drejtohet Gjykatës Kushtetuese, pasi bazuar në jurisprudencën e GJEDNJ-së mosmarrëveshjet e lindura në fushën e tatim-taksave bien jashtë fushëveprimit të të drejtave dhe detyrimeve civile, pavarësisht nga efektet në të holla që ato prodhojnë detyrimisht për tatimpaguesit. Gjykata, duke rikonfirmuar qëndrimin e saj në vendimin nr. 33, datë 8.6.2016, vlerëson se bazuar në rëndësinë që paraqet klasifikimi i mosmarrëveshjeve në fushën e



tatimeve për garantimin e të drejtave dhe lirive themelore të subjekteve tregtare, si dhe nisur nga qëllimi i veprimtarisë së kërkueses për mbrojtjen e të drejtave dhe interesave të tatimpaguesve, provohet lidhja e drejtpërdrejtë midis veprimtarisë ligjore për të cilën ajo është krijuar dhe çështjes kushtetuese të pretenduar prej saj. *Prima facie* i takon juridiksionit kushtetues vlerësimi i mosmarrëveshjeve të lindura në fushën e tatimeve dhe të taksave, të cilat pavarësisht nga efektet në të holla që detyrimisht prodhojnë për tatimpaguesin, përfshihen në fushëveprimin e të drejtave dhe detyrimeve civile. Në këtë kuptim, Gjykata vlerëson se është e drejta e kërkueses që në çdo rast, kur konstaton se një normë cenon interesat e saj, në tërësi ose në veçanti, t'i drejtohet juridiksionit kushtetues me kërkesë për shfuqizimin e normës konkrete (*shih vendimin nr. 33 datë 8.6.2016 të Gjykatës Kushtetuese*). Për rrjedhojë, kërkesja, Shoqata për Mbrojtjen e Tregtarëve dhe të Tregut, legjitimohet *ratione materiae* në kërkimet e saj.

16. Gjykata vëren, gjithashtu, se me kërkesën e datës 5.10.2016 kërkesja, Dhoma e Tregtisë dhe Industrisë, ka deklaruar heqjen dorë nga kërkesa e paraqitur, për arsye që lidhen me aktualitetin e çështjeve që përbëjnë objekt kërkesë, si dhe në funksion të përfaqësimit sa më të drejtë dhe mbrojtjes më të mirë të interesave të biznesit që përfaqëson, duke kërkuar pushimin e shqyrtimit të kësaj çështjeje. Sipas nenit 31/b të ligjit nr. 8577/2000, të ndryshuar, kërkuesi mund të heqë dorë nga kërkesa përpara fillimit të shqyrtimit të saj nga Gjykata dhe në këtë rast vendoset pushimi i gjykimit të çështjes. Për rrjedhojë, në seancë plenare Gjykata vendosi pranimin e kërkesës së paraqitur nga kërkesja, Shoqata e Tregtisë dhe Industrisë, për heqjen dorë nga gjykimi i çështjes dhe pushimin e gjykimit të çështjes në lidhje me këtë kërkesë.

17. Gjykata vëren, gjithashtu, se me kërkesën e datës 8.9.2016 Bashkia e Tiranës ka kërkuar të marrë pjesë në gjykim si subjekt i interesuar me pretendimin se duke qenë bashkia më e madhe në vend, e cila një pjesë të konsiderueshme të investimeve e realizon nëpërmjet të ardhurave të vjela nga taksa e ndikimit në infrastrukturë, ka interes të drejtpërdrejtë në çështjen në shqyrtim. Gjithashtu, sipas këtij subjekti, Këshilli Bashkiak i Tiranës ka miratuar vendimin nr. 59, datë 30.12.2015 “Për sistemin e taksave dhe tarifave

vendore në qytetin e Tiranës”, i cili është kundërshtuar në gjykatë dhe aktualisht është për gjykim në Gjykatën e Lartë. Gjykata vëren se sipas nenit 39/1 të ligjit nr. 8577/2000, pjesëmarrës në gjykimin kushtetues janë: a) subjekti që ka paraqitur kërkesën ose përfaqësuesi i tij; b) subjektet kundër të cilave është paraqitur kërkesa ose që kanë interes të drejtpërdrejtë për çështjen që shqyrtohet; c) organi që ka nxjerrë aktin; ç) organet shtetërore që janë në mosmarrëveshje për kompetencë. Në kuptim të kësaj dispozite, pasi mori në shqyrtim kërkesën e paraqitur nga Bashkia e Tiranës, Gjykata vlerësoi se nuk ndodhet para rasteve të parashikuara në këtë dispozitë, pasi nuk është provuar interesi i drejtpërdrejtë në çështjen në shqyrtim, për rrjedhojë vendosi rrëzimin e saj.

B. Për kërkesën për pezullimin e zbatimit të ligjit

18. Kërkuesit kanë kërkuar pezullimin e zbatimit të ligjit nr. 142/2015 deri në dhënien e vendimit përfundimtar të Gjykatës me pretendimin se ky ligj cenon interesat e komunitetit të biznesit dhe të individëve dhe se dëmi që mund të shkaktohet nga zbatimi i tij është i rëndë dhe pothuajse i pamundur për t'u riparuar.

19. Mbledhja e Gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese, në kuptim të nenit 45 të ligjit nr. 8577/2000, pasi mori në shqyrtim shkaqet e parashtruara nga kërkuesit, vlerësoi se në rastin konkret nuk plotësohen kërkesat e parashikuara në këtë dispozitë dhe se nuk ka argumente bindëse për mundësinë e cenimit të interesave shtetërorë, shoqërorë ose të individëve nga zbatimi i këtij ligji. Për rrjedhojë, me vendimin e datës 18.7.2016, ajo vendosi rrëzimin e kësaj kërkesë si të pabazuar.

20. Në seancën plenare të datës 6.10.2016, përfaqësuesit e kërkueses, Shoqatës për Mbrojtjen e Tregtarëve dhe të Tregut, përsëritën para Gjykatës kërkesën për pezullimin e zbatimit të ligjit objekt shqyrtimi. Pasi mori në shqyrtim këtë kërkesë, Gjykata me shumicë votash³, vlerësoi sërish rrëzimin e saj për të njëjtat arsye si më sipër.

C. Për themelin e pretendimeve të paraqitura nga kërkuesja

C.1 Për pretendimin për fuqinë prapavepruese të ligjit

21. Sipas kërkueses gjatë procedurës së hyrjes në fuqi të ligjit janë shkelur nenet 84, 117 dhe 155 të

³ Votuan për marrjen e masës së pezullimit gjyqtarët V. Kristo, V. Tusha dhe F. Lulo.



Kushtetutës. Edhe pse ligji nr. 142/2015 është botuar në Fletoren Zyrtare të datës 22 janar 2016, në nenin 18 të tij është parashikuar hyrja në fuqi në datën 1 janar 2016, ndërkohë që sipas nenit 84/3 të Kushtetutës ligji hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare. Në rastin konkret nuk ndodhemi përballë ndonjë situatë të jashtëzakonshme apo rast nevojë a urgjence që do të justifikonte hyrjen e menjëhershme në fuqi të tij në kuptim të nenit 84/4 të Kushtetutës. Po ashtu, neni 155 i Kushtetutës përcakton një klauzolë imperative, duke parashikuar në mënyrë eksplicite se në rastet e taksave, tatimeve dhe detyrimeve financiare kombëtare e vendore ligjit nuk mund t'i jepet fuqi prapavepruese.

22. Sipas subjektit të interesuar, Kuvendit, përcaktimi për hyrjen në fuqi të ligjit në datën 1 janar 2016 është pasojë e nevojës për të sjellë impakt financiar të menjëhershëm për këtë vit, por edhe pasojë e një gabimi në përlllogaritjen e afateve të domosdoshme që vetë Kushtetuta parashikon për shpalljen dhe hyrjen në fuqi të një ligji. Kjo ka sjellë që për një periudhë 37-ditore, edhe pse nuk ka qenë vullneti i ligjvënësit, të krijohet *de facto*, në fazën e zbatimit të këtij ligji, premisa për dhënien e fuqisë prapavepruese ligjit. Megjithatë, në rastin konkret nuk kemi të bëjmë me dhënien e ligjit fuqi prapavepruese, por përkundrazi me hyrjen në fuqi të tij, aspekt ky i parashikuar nga dispozitat kushtetuese, të cilat në rastin konkret duhet të zbatoheshin drejtpërdrejtë prej organeve të shtetit që janë të ngarkuara për zbatimin e ligjit objekt kërkese. Sipas këtij subjekti, ligji ka krijuar detyrime të reja për këtë periudhë, por, nga ana tjetër, ka krijuar edhe lehtësi e privilegje për operatorët, pasi ka hequr dhe reduktuar një sërë detyrimesh për disa kategori. Nga ana tjetër, subjektet kanë të drejtë të ankohen pranë vetë organit që zbaton ligjin, si edhe në organet gjyqësore për rregullimin e pasojave nga zbatimi i tij për periudhën 37-ditore. Kurse sipas subjektit të interesuar, Këshillit të Ministrave, shtrirja e efekteve të taksave sipas këtij ligji është deri më 31 dhjetor të vitit në vijim, kështu që hyrja në fuqi e tij në shkurt dhe shtrirja e efekteve që nga janari nuk e bën atë antikushtetues. Për efekt të të gjithë sistemit të përlllogaritjes së taksave, viti ushtrimor merret si një i tërë. Ai fillon në datën 1 janar dhe përfundon në datën 31 dhjetor.

23. Gjykata vlerëson se pretendimet e mësipërme duhet të trajtohen në këndvështrim të parimit të sigurisë juridike. Lidhur me këtë parim në jurisprudencën kushtetuese është theksuar se ai, si një nga elementet e parimit të shtetit të së drejtës të sanksionuar në nenin 4 të Kushtetutës, përfshin, mes të tjerash, besueshmërinë e qytetarëve të shteti dhe pandryshueshmërinë e ligjit për marrëdhëniet e rregulluara. Besueshmëria ka të bëjë me bindjen e individit se nuk duhet të shqetësohet vazhdimisht ose të jetojë me frikë për ndryshueshmërinë dhe pasojat negative të akteve juridike, të cilat mund të cenojnë jetën e tij private ose profesionale dhe të përkeqësojnë një gjendje të vendosur me akte të mëparshme. Rregullimet ligjore që kanë të bëjnë me të drejtat e shtetasve duhet të kenë qëndrueshmëri të mjaftueshme që siguron vijimësinë e tyre. Si rregull, nuk mund të mohohen interesat dhe pritshmëri të ligjshme të qytetarëve nga ndryshimet në legjislacion dhe shteti duhet të synojë të ndryshojë një situatë të rregulluar më parë vetëm nëse ndryshimi sjell pasojë pozitive (*shih vendimin nr. 43, datë 26.6.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

24. Sanksionimi i të drejtave dhe lirive të njeriut të pranuar në Kushtetutë dhe shoqërimi i tyre me masat për vënien në jetë të tyre duhet të synojë përmirësimin dhe rritjen e standardeve të të drejtave, si dhe forcimin e shtetit ligjor. Nëse masat e marra shpiten në përkeqësimin në mënyrë të paarsyeshme të gjendjes ligjore të personave të tjerë, mohojnë të drejtat e fituara ose injorojnë interesat legjitim të këtyre, atëherë do të dhunohet parimi kushtetues i barazisë së të drejtave dhe, në përgjithësi, do të rrezikohet arritja e qëllimit madhor të ndërtimit të shtetit të së drejtës. Në këtë kuptim, Gjykata vëren se parimi i sigurisë juridike nuk shfaqet asnjëherë si i tillë në vetvete, por shoqërohet me mbrojtjen e të drejtave të fituara, vazhdimësinë ligjore, ndalimin e ligjeve me fuqi prapavepruese, qartësinë dhe përcaktueshmërinë në normimin e marrëdhënieve juridike, respektimin e pritshmërive legjitime etj. (*shih vendim nr. 10, datë 29.2.2016 të Gjykatës Kushtetuese*).

25. Parimet themelore të një shteti të së drejtës nënkuptojnë, midis të tjerave, edhe ndalimin e fuqisë prapavepruese të normave juridike, i cili buron nga kërkesat e sigurisë



juridike, çka do të thotë se është e pamundur të gjykohen, sipas normave ligjore në fuqi, sjellje njerëzore, fakte ligjore ose marrëdhënie ligjore që kanë ndodhur para se norma të hynte në fuqi. Si rregull, ligjet i shtrijnë efektet e tyre në kohën e ardhme dhe fuqia prapavepruese e tyre zbatohet në raste përjashtimore, sepse në të kundërt mund të krijohen situata me pasoja të paparashikuara. Teoria e së drejtës pranon se fuqia prapavepruese zbatohet si përjashtim, për shembull, në ligjet penale favorizuese, në ligjet që ndërhyjnë për të rregulluar me ligj situata të paligjshme të krijuara më parë, në ligjet që interpretojnë anët e errëta ose të paqarta të një ligji të mëparshëm e në ndonjë rast tjetër ku paraqitet domosdoshmëria për të shmangur pasoja të rënda, negative ose të pandreqshme (*shih vendimin nr. 31, datë 18.6.2010 të Gjykatës Kushtetuese*). Doktrina ka pranuar se parimi i fuqisë prapavepruese është i pranishëm në rastet kur një normë ligjore aplikohet për gjëra tashmë të vendosura në të kaluarën. Në këtë drejtim Gjykata ka pranuar se në raste përjashtimore Kuvendi mund të miratojë ligje retroaktive ose të legalizojë me efekte retroaktive praktika ose marrëdhënie ekzistuese, të cilat njihen në doktrinën kushtetuese si ligje legalizuese, por kjo ndërhyrje duhet të justifikohet nga interesi publik (*shih vendimin nr. 31, datë 18.6.2010 të Gjykatës Kushtetuese*). Megjithatë, për sa i takon legjislacionit në fushën e tatim-taksave, Kushtetuta në mënyrë taksative, në nenin 155 të saj, ka përcaktuar se ato caktohen me ligj dhe në këto raste ligjit nuk mund t'i jepet fuqi prapavepruese, për rrjedhojë ligjvënësi nuk ka asnjë hapësirë vlerësimi në këto raste dhe duhet të respektojë këtë detyrim që buron drejtpërdrejt nga norma kushtetuese.

26. Duke ju rikthyer çështjes konkrete në shqyrtim rezulton se ligji nr. 142/2015 është miratuar në datën 17.12.2015 dhe është botuar në Fletoren Zyrtare të datës 22 janar 2016. Sipas nenit 84/3 të Kushtetutës ligji hyn në fuqi me kalimin e jo më pak se 15 ditëve nga botimi i tij në Fletoren Zyrtare, për rrjedhojë ai ka hyrë në fuqi në datën 8 shkurt 2016. Mirëpo ligji nr. 142/2015 në nenin 18 të tij ka parashikuar se “*ky ligj botohet në Fletoren Zyrtare dhe hyn në fuqi më 1 janar 2016*”, duke sjellë si pasojë që ndryshimeve të reja ligjore t’u jepet fuqi prapavepruese edhe për periudhën përpara datës së hyrjes në fuqi,

periudhë gjatë të cilës duhej të zbatoheshin të gjitha kategoritë dhe nivelet e taksave vendore sipas ligjit nr. 9632/2006 pa ndryshimet e kundërshtuara.

27. Për sa më sipër, Gjykata vlerëson se ligji nr. 142/2015 në pjesën që i jep efekt prapaveprues dispozitave të tij bie ndesh me parimin e sigurisë juridike, për rrjedhojë neni 18 i tij duhet të shfuqizohet si jokushtetues.

C.2. Për pretendimin e cenimit të lirisë së veprimtarisë ekonomike dhe të së drejtës së pronës private

28. Kërkuesja ka pretenduar se vendosja e taksës së truallit apo ndryshimi i nivelit të taksës së ndikimit në infrastrukturë nga 1-4% të vlerës së investimit në 4-8% të çmimit të shitjes sipas referencave përbën një ashpërsim të shpërpjesëtuat të masës kufizuese në favor të interesit publik. Normat e reja ligjore që parashikojnë taksa në vlera të paarsyeshme, si taksa e re e truallit apo taksa në infrastrukturë, të cilat çojnë pothuajse në shkatërrim të biznesit të taksapaguesve, kufizojnë në mënyrë joproporcionale lirinë e veprimtarisë ekonomike dhe të drejtën e pronës, në referim të neneve 11 dhe 41 të Kushtetutës. Sipas saj, rritja e taksave vendore është jo vetëm disproporcionale, në kundërshtim me nenin 17 të Kushtetutës, por vjen në kundërshtim të hapur edhe me parimin e aftësisë paguese, sipas nenit 155 të Kushtetutës. Ligji i kundërshtuar cenon parimin e proporcionalitetit, pasi rritja e nivelit të taksave nuk shoqërohet me nevojën për kufizimin e garancive kushtetuese, kjo për faktin se asnjë e dhënë apo studim i kryer nuk tregon ndonjë lidhje të qenësishme dhe të drejtë midis masave të marra dhe rezultateve të dëshiruara. Për më tepër nuk ka asnjë balancim midis interesit që synohet të mbrohet dhe të drejtave të subjekteve që u kufizohen.

29. Sipas subjekteve të interesuara ndryshimet e miratuara me ligjin nr. 142/2015 janë rezultat i një analize të plotë dhe të kujdesshme. Kufizimi që është vendosur me këtë ligj plotëson kriteret kushtetuese, pasi është i vendosur me ligj, është proporcional dhe justifikohet nga qëllimi i sistemit tatimor për mirëqenien e përgjithshme. Gjatë procesit të diskutimit të projektligjit në Komisionin e Ekonomisë është zhvilluar një seancë dëgjimore me shoqatat e biznesit për projektligjet financiare që shoqëronin projektbuxhetin e vitit 2016 dhe pasi



u dëgjuan dhe u analizuan propozimet, u miratuan disa ndryshime me qëllim krijimin e balancës së duhur ndërmjet kufizimeve dhe lehtësirave. Në lidhje me taksën e ndikimit në infrastrukturë, e parashikuar në nenin 14/2 të ligjit nr. 142/2015 (neni 27/2 i ligjit nr. 9632/2006), që ka qenë edhe dispozita më e kundërshtuar, Kuvendi ka miratuar një shtesë në ligjin bazë, masë që u bazuar në propozimin e Shoqatës së Bashkive, pasi u argumentua se vendosja e një tavani të lartë për taksën fikse bën të mundur që të nxitet zhvillimi në zonat që kanë ndikim më të madh në zhvillimin ekonomik të vendit dhe të ngadalësohet ndërtimi në hapësira të mbindërtuara e të urbanizuara tej limiteve të mundshme infrastrukturore. Pra, kjo taksë ka një interes të rëndësishëm publik, e cila lidhet me dendësinë e banorëve në infrastrukturën publike. Nga analiza e detajuar për disa prej taksave të trajtuara nga ligji nr. 142/2015 rezulton se disa janë hequr (tatimi i thjeshtuar mbi fitimin e biznesit të vogël për subjektet me qarkullim vjetor nën 5 milionë lekë), kurse disa të tjera janë reduktuar ndjeshëm (2.5% tatimi i thjeshtuar mbi fitimin e biznesit të vogël për subjektet me xhiro nga 5-8 milionë lekë, përgjysmim i taksës për ndërtesat, reduktim i taksës së fjetjes për qëllime turizmi). Përmes miratimit të ligjit nr. 142/2015, Kuvendi ka mundësuar një politikë tejet balancuese heqjeje dhe reduktimi taksash përkundrejt rritjes së ndonjë takse, siç është ajo e ndikimit në infrastrukturë.

30. Sipas nenit 11/1 të Kushtetutës sistemi ekonomik bazohet në pronën private e publike, si dhe në ekonominë e tregut dhe në lirinë e veprimtarisë ekonomike. Gjykata ka vlerësuar se liria e veprimtarisë ekonomike, nënkupton, kryesisht, të drejtën për të lidhur kontrata, individualisht ose kolektivisht, lirisht dhe mbi bazën e vullnetit personal, të drejtën për të zgjedhur aktivitetin që dëshiron të ushtrojë individi, të drejtën për të zgjedhur një punë sipas preferencës etj. Kjo liri përfshin të gjitha të drejtat që lidhen me prodhimin, shpërndarjen ose konsumin e mallrave dhe të shërbimeve, por forma më e lartë e saj nënkupton të drejtën e pronës, lirinë pa asnjë kufizim të qarkullimit të fuqisë punëtore, të kapitalit dhe të mallrave. Po ashtu, liria e veprimtarisë ekonomike përban në vetvete edhe lirinë e biznesit ose aftësinë për të

krijuar dhe mbyllur një sipërmarrje, lirinë e tregtisë ose mungesën e barrierave lidhur me importimin dhe eksportimin e mallrave dhe shërbimeve, lirinë monetare si masë për të garantuar qëndrueshmëri të çmimit, lirinë fiskale mbi të ardhurat qoftë individuale, qoftë ndaj biznesit në mënyrë të veçantë, të drejtat e pronës si aftësi e individëve për të grumbulluar, poseduar dhe disponuar sende, të lirë nga ndërhyrja e shtetit, lirinë e investimit dhe qarkullimit të lirë të kapitaleve, veçanërisht kapitalit të huaj, lirinë financiare dhe pavarësinë nga kontrolli shtetëror, lirinë e punës për të ndërvepruar pa kufizime nga shteti (*shih vendimin nr. 33, datë 8.6.2016 të Gjykatës Kushtetuese*).

31. Liria e veprimtarisë ekonomike përban edhe detyrimin e shtetit që nëpërmjet ligjvënësit të ndërhyjë në rregullimin e saj, me qëllim që të garantohet edhe parimi i shtetit social dhe i të mirës së përbashkët. Ky detyrim për rregullim i ligjvënësit shprehet nëpërmjet nxjerrjes së normave konkrete juridike, me anë të të cilave synohet disiplinimi i ushtrimit të veprimtarisë së lirë ekonomike në sektorë apo fusha të caktuara. Në këtë rast shteti duhet të luajë rolin e katalizatorit për realizimin efektiv të lirisë ekonomike, nga njëra anë, dhe mbrojtjes së kësaj lirie, nga ana tjetër. Vetëm shteti mund të arrijë të krijojë mjedisin e vërtetë dhe optimal për ushtrimin e kësaj lirie vetjake, prandaj ai duhet parë si rregullator me qëllim mbrojtjen e tregut nga deformimet që natyrshëm mund t'i mbartë me vete zhvillimi i lirë i veprimtarisë ekonomike (*shih vendimin nr. 33, datë 8.6.2016 të Gjykatës Kushtetuese*).

32. Gjykata vëren se në rastin konkret ballafaqohen interesat e tregtarëve për të ushtruar lirinë e veprimtarisë ekonomike dhe, e parë si pjesë e kësaj lirie, për të gëzuar qetësisht pronën e tyre, nga njëra anë, me interesat e shtetit për miratimin e një sërë normash rregulluese në aspektin procedural lidhur me administrimin e taksave vendore duke përcaktuar taksa të reja apo shfuqizuar disa të tjera, nga ana tjetër. Për të vlerësuar nëse në këtë rast kushti i baraspeshës është respektuar apo është përmbysur, pra nëse taksapaguesit janë ngarkuar me një barrë apo peshë individuale tej masës ose shkallës së duhur, sado i rëndësishëm të jetë interesi publik ose i komunitetit në përgjithësi, në jurisprudencën e saj gjykata ka çmuar të nevojshme të vlerësojë nëse strategjia e

ndërhyrjes së ligjvënësit respekton kriteret e mëposhtme: i) nëse objektivi i ligjvënësit është mjaftueshëm i rëndësishëm për të justifikuar kufizimin e së drejtës; ii) nëse masat e marra janë të lidhura në mënyrë të arsyeshme me objektivin - ato nuk mund të jenë arbitrare, të padrejta ose të bazuara mbi vlerësime alogjike; iii) nëse mjetet e përdorura nuk janë më të ashpra se sa duhen për të arritur objektivin e kërkuar - sa më të mëdha efektet e dëmshme të masës së përzgjedhur, aq më tepër duhet të jetë i rëndësishëm objektivi për t'u arritur, në mënyrë që masa të justifikohet si e nevojshme.

33. Gjykata ka theksuar se proporcionaliteti i një kufizimi vlerësohet rast pas rasti, duke pasur parasysh se aspektet e mësipërme nuk duhet të analizohen veç e veç, por të gërshetuara me njëra-tjetrën (shih vendimin nr. 33, datë 26.1.2016 të Gjykatës Kushtetuese). Pra në thelb të parimit të proporcionalitetit qëndron ekuilibrimi i drejtë i interesave, vlerësimi objektiv i tyre, si dhe shmangia e konfliktit nëpërmjet përzgjedhjes së mjeteve të duhura për realizimin e tyre (shih vendimet nr. 52, datë 5.12.2012; nr. 1 datë 6.2.2013 të Gjykatës Kushtetuese). Për sa i përket listës së çështjeve me interes publik, Gjykata ka theksuar se ajo nuk mund të jetë kurrsesi shteruese, pasi interesi publik duhet kuptuar në sensin relativ, në varësi të situatave të ndryshme që krijohen (shih vendimin nr. 18, datë 14.5.2003 të Gjykatës Kushtetuese).

34. Në praktikën kushtetuese është pranuar tashmë se ligjvënësi, parimisht, është i lirë të veprojë brenda hapësirës së tij normuese duke përcaktuar qartë dhe rast pas rasti qëllimet që kërkon të arrijë. Në respektim të interesit publik pranohen si kufizime të arsyeshme të lirisë së veprimtarisë ekonomike iniciativat e ligjvënësit, të cilat shërbejnë për një rregullim të tregut apo interesave të një shteti social. Parimi i shtetit social, i parashikuar që në preambulën e Kushtetutës sonë, e përlligj ndërhyrjen e autoritetit publik në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë edhe në marrëdhëniet juridike private për të mbrojtur interesat e përgjithshëm, siç janë kontrolli publik i kostos së jetesës, lufta kundër inflacionit, shtytja dhe nxitja e aktiviteteve prodhuese, mbrojtja e shtresave të varfra, promovimi i vlerave sociale, etj. (shih vendimin nr. 52, datë 5.12.2012 të Gjykatës Kushtetuese). Masat e ligjvënësit mund të jenë të shumëllojshme, madje edhe të karakterit monetar, por ajo që ka rëndësi

në këtë rast është që thelbi i këtij aktiviteti të individit të mos cenohet deri në atë masë sa të bëhet i pamundur ushtrimi i tij (shih vendimin nr. 10, datë 19.3.2008 të Gjykatës Kushtetuese).

35. Megjithatë, për shkak të natyrës teknike që paraqet kuadri ligjor i tatimeve dhe taksave, diskrecioni i ligjvënësit duhet të respektojë në të gjitha rastet domosdoshmërisht parimet e drejtësisë dhe të shtetit të së drejtës të sanksionuara në Kushtetutë. Këto parime janë universale. Ato duhet të ndiqen si në bërjen e ligjeve, ashtu dhe në zbatimin e tyre. Ato nënkuptojnë se të gjitha institucionet shtetërore duhet të veprojnë vetëm në bazë dhe në zbatim të ligjit dhe se të drejtat dhe liritë e njeriut duhet të respektohen. Gjithashtu, ato presupozojnë faktin se masat e vendosura nga shteti duhet të jenë proporcionale, në përputhje me objektivat legjitimë e të rëndësishëm dhe nuk duhet të vendosin kufizime në një masë më të madhe se sa është e nevojshme për të arritur këta objektiva.

36. Gjykata rithekson se në vlerësimin e kushtetutshmërisë së ligjeve ajo nisat nga prezumimi i pajtueshmërisë së tyre me Kushtetutën. Kjo do të thotë se lidhur me antikushtetutshmërinë e pretenduar duhet të parashtrihen argumente bindëse për t'i dhënë mundësi kësaj Gjykate të vlerësojë nëse zgjidhjet ligjore të zbatuara shkelin normat dhe vlerat kushtetuese (shih vendimin nr. 4, datë 23.2.2016 të Gjykatës Kushtetuese).

37. Duke iu rikthyer çështjes konkrete, Gjykata vëren se në thelb pretendimet e kërkuases lidhen me nivelin e ri të taksës në infrastrukturë, ndryshime që janë sjellë me nenin 14 të ligjit nr. 142/2015. Gjykata vëren se sipas nenit 27 të ligjit nr. 9632/2006 (përpara ndryshimeve të kundërshtuara) baza e taksës të ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja është vlera në lekë e investimit të ri që kërkohet të kryhet (pika 1). Niveli i saj shprehet si përqindje e vlerës së investimit dhe është 1–3% e kësaj vlere, ndërsa për Bashkinë e Tiranës 2–4% e vlerës së saj (pika 2). Neni 14 i ligjit nr. 142/2015, i cili ka ndryshuar nenin 27 të sipërcituar, ka parashikuar se në rastin e ndërtimeve për qëllime banimi apo njësi shërbimi nga shoqëritë e ndërtimit, të cilat nuk destinohen për përdorim në sektorin e turizmit, industrisë apo përdorim publik, taksa është në masën 4–8%



të çmimit të shitjes për metër katror (pika 2), kurse në rastet e ndërtimeve të ndryshme nga ato të përcaktuara në pikën 2 të këtij neni, niveli i taksës shprehet si përqindje e vlerës së investimit dhe është 1–3% e kësaj vlere, ndërsa për Bashkinë e Tiranës 2–4% të vlerës së saj (pika 3).

38. Sipas kërkuësës ky rregullim sjell një dyfishim të kufijve për taksën e ndikimit në infrastrukturë në rastin e ndërtimeve për qëllime banimi apo njësi shërbimi nga shoqëritë e ndërtimit dhe kjo rritje është disproporcionale, në kundërshtim me nenin 17 të Kushtetutës, por vjen në kundërshtim të hapur edhe me parimin e aftësisë paguese, sipas nenit 155 të Kushtetutës. Rritja e nivelit të taksave nuk shoqërohet me nevojën për kufizimin e garancive kushtetuese, kjo për faktin se asnjë e dhënë apo studim i kryer nuk tregon ndonjë lidhje të qenësishme dhe të drejtë midis masave të marra dhe rezultateve të dëshiruara.

39. Gjykata gjatë votimit të çështjes, për sa i takon pretendimit të kërkuësës në lidhje me nenin 14 të ligjit nr. 142/2005, i cili ka ndryshuar nenin 27 të ligjit nr. 9632/2006, nuk arriti shumicën e të gjithë anëtarëve të saj të kërkuar nga neni 133/2 i Kushtetutës dhe neni 72/2 i ligjit nr. 8577/2000⁴. Në këto kushte, Gjykata, në bazë të nenit 74 të ligjit nr. 8577/2000, që është dispozita e zbatueshme në rastin konkret, vendosi refuzimin e kërkesës për këtë pretendim.

40. Gjykata vëren se mes ndryshimeve që ka sjellë ligji i kundërshtuar nr. 142/2015, përveç nivelit të taksës së ndikimit në infrastrukturë, është edhe përfshirja e taksës mbi truallin në taksën mbi pasurinë e paluajtshme (neni 4), ndryshimi i shkallës tatimore të aplikueshme mbi fitimin e tatuashëm (neni 5), si dhe baza dhe niveli i taksës mbi truallin (neni 12) apo baza e taksës së fjetjes në hotel (neni 13). Në lidhje me këto ndryshime kërkuësja nuk ka arritur të parashtrojë argumente kushtetuese në lidhje me cenimin që kanë sjellë ato në lirinë e saj për të ushtruar veprimtarinë ekonomike dhe të drejtën e pronës private si një nga elementet e kësaj lirie. Gjykata rithekson se tatimet dhe taksat janë pjesë e sistemit financiar të buxhetit të shtetit. Buxheti i shtetit krijohet nga të

ardhurat e mbledhura prej taksave, tatimeve dhe detyrimeve të tjera financiare, si dhe prej të ardhurave të tjera të ligjshme (neni 157 i Kushtetutës). Qëllimi i sistemit tatimor është mirëqenia e përgjithshme, që do të thotë e individëve dhe e komunitetit në përgjithësi, si dhe përmbushja e objektivave sociale të shtetit. Dispozitat e neneve 155 dhe 157 të Kushtetutës, të cilat konsolidojnë sistemin buxhetor dhe përcaktojnë burimet e krijimit të të ardhurave të buxhetit të shtetit, sanksionojnë detyrimin kushtetues për të paguar detyrimet tatimore. Taksat dhe tatimet nuk janë detyrime të negociueshme dhe mbliidhen nga organet tatimore, me mënyrat e përcaktuara me ligj. Marrëdhëniet e tatim-taksave janë marrëdhënie ligjore detyrimi ndërmjet shtetit dhe tatimpaguesve dhe si të tilla ato mund të përcaktohen vetëm me ligj (*shih vendimin nr. 16, datë 25.7.2008 të Gjykatës Kushtetuese*).

41. Gjykata vlerëson se në rastin konkret janë respektuar kërkesat e nenit 155 të Kushtetutës për miratimin me ligj të ndryshimeve të kundërshtuara. Po ashtu, këto ndryshime janë bërë për një interes publik dhe justifikohen me qëllimin që kërkohet të arrihet, që është rregullimi i tregut dhe interesat e shtetit social. Ndryshimet e sjella për disa nga taksat vendore në nivelin apo mënyrën e llogaritjes së tyre, në vlerësimin e Gjykatës nuk konsiderohen si të paarsyeshme apo të papërshtatshme për të justifikuar arritjen e qëllimit dhe të objektivit për të cilin ato janë parashikuar. Këto ndryshime sigurojnë baraspeshën e kërkuar mes së drejtës së kufizuar dhe interesit publik dhe nuk rezulton që të kenë vendosur një barrë të tepruar e të papërbalueshme për subjektet taksapaguese. Për rrjedhojë, pretendimi i kërkuësës për cenimin e lirisë së veprimtarisë ekonomike dhe të së drejtës së pronës është i pabazuar dhe duhet të rrëzohet.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 131/f, 134/1/g dhe 133/2 të Kushtetutës, si dhe të neneve 72/2 dhe 74 të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”,

⁴ Votuan për rrëzimin gjyqtarët: B. Dedja, B. Imeraj dhe F. Lulo. Votuan për pranimin gjyqtarët: V. Kristo, V. Tusha, G. Dizdari dhe F. Hoxha.



VENDOSI:

- Pranimin pjesërisht të kërkesës.
 - Shfuqizimin si të papajtuëshëm me Kushtetutën të nenit 18 të ligjit nr. 142/2015 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, të ndryshuar”.
 - Refuzimin e kërkesës për shfuqizimin e nenit 14 të ligjit nr. 142/2015, që ka ndryshuar nenin 27 të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, të ndryshuar.
 - Rrëzimin e kërkesës për pjesën tjetër.
- Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë: Bashkim Dedja (kryetar), Vitore Tusha, Vladimir Kristo, Gani Dizdari, Fatmir Hoxha, Besnik Imeraj, Fatos Lulo

VENDIM

Nr. 17, datë 1.3.2017

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Bashkim Dedja	kryetar i	Gjykatës Kushtetuese
Vladimir Kristo	anëtar i	“ “
Vitore Tusha	anëtare e	“ “
Gani Dizdari	anëtar i	“ “
Besnik Imeraj	anëtar i	“ “
Fatos Lulo	anëtar i	“ “
Fatmir Hoxha	anëtar i	“ “

me sekretare Belma Lleshi, në datën 17.1.2017 mori në shqyrtim në seancë plenare, mbi bazë dokumentesh, çështjen me nr. 86/22 Akti, që u përket palëve:

KËRKUESE: Shoqëria “Gen-red” sh.p.k.

SUBJEKTE TË INTERESUARA: Banka e Shqipërisë, Avokatura e Shtetit

OBJEKTI: Shfuqizimi si i papajtuëshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë i vendimit nr. 00-2015-2877 (344), datë 28.5.2015 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë.

BAZA LIGJORE: Nenet 42, 131/f dhe 134/1/i të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të ndryshuar; neni 6 i Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut; ligji nr. 8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe

funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Fatmir Hoxha, shqyrtoi pretendimet e kërkuases, që kërkoi pranimin e kërkesës, pretendimet e subjekteve të interesuara Avokaturës së Shtetit dhe Bankës së Shqipërisë, që kërkuan rrëzimin e kërkesës, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

1. Kërkuësja, shoqëria “Gen-Red”, me vendimin e datës 1.2.1999 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë është e regjistruar si person juridik me objekt aktiviteti prodhimin restaurimin, montimin dhe shërbime tregtare me shumicë dhe pakicë. Midis kërkuases në cilësinë e sipërmarrëses dhe subjektit të interesuar, Bankës së Shqipërisë, është lidhur kontrata e sipërmarrjes nr. 4167, datë 18.7.2007 me objekt “Punimet e rikonstruksionit në godinën e Degës së Bankës së Shqipërisë” në qytetin e Beratit. Në kontratë është parashikuar se koha e përmbushjes së detyrimit është 120 ditë kalendrike nga data e nënshkrimit të saj.

2. Për shkak të mospërmbushjes së detyrimit për likuidimin e shumës prej 4.383.982 lekësh nga subjekti i interesuar, kërkuësja i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë me padi me objekt detyrimin e subjektit të interesuar të likuidojë në favor të kërkuases shumë 4.383.982 lekë sipas kontratës nr. 4167, datë 18.7.2007 të lidhur mes palëve.

3. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. 259, datë 24.1.2011, ka vendosur pranimin e kërkesëpadisë.

4. Mbi ankimin e Bankës së Shqipërisë dhe Avokaturës së Shtetit, Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. 154, datë 25.1.2012, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. 259, datë 24.1.2011 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

5. Mbi rekursin e Avokaturës së Shtetit, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2015-2877 (344), datë 28.5.2015, ka vendosur ndryshimin e vendimit nr. 259, datë 24.1.2011 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe të vendimit nr. 154, datë 25.1.2012 të Gjykatës së Apelit si dhe rrëzimin e padisë.



II

6. **Kërkuesja, shoqëria “Gen-Red” sh.p.k.**, i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese duke pretenduar shfuqizimin e vendimit nr. 00-2015-2877 (344), datë 28.5.2015 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë me argumentet si vijojnë:

6.1 Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë nuk i ka njoftuar kërkueses rekursin e Avokaturës së Shtetit. Kërkueses duke mos iu dhënë mundësia të paraqesë kundërrekurs brenda afatit ligjor, i është mohuar e drejta për të marrë pjesë në gjykim.

6.2 Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë ka cenuar parimin e gjykimit nga një gjykatë e caktuar me ligj, pasi ka riçelur hetimin gjyqësor duke i rivlerësuar provat e nënshtruara debatit gjyqësor në gjykatat më të ulëta.

6.3 Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë ka cenuar parimin e arsytimit të vendimit gjyqësor pasi vendimi është kontradiktor dhe jologjik.

7. **Subjekti i interesuar, Avokatura e Shtetit**, ka paraqitur parashtrime me shkrim duke argumentuar si vijon:

7.1 Gjykata e Lartë ka vepruar në përputhje me dispozitat ligjore për njoftimin e palëve Nga aktet e dosjes rezulton që kërkuesja ka marrë dijeni për rekursin e subjekteve të interesuara dhe nuk ka paraqitur kundërrekurs brenda afatit ligjor.

7.2 Kolegji nuk ka administruar prova të reja si dhe nuk ka bërë rivlerësim të provave të administruara në gjykimet e faktit. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë ka vepruar në bazë të ligjit duke i vlerësuar vendimet e gjykatave si të pabazuara në ligj.

7.3 Vendimi i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë i përmbush standardet e vendosura nga jurisprudenca kushtetuese për arsytimin e vendimit gjyqësor. Kolegji në përputhje me kompetencat e tij ka marrë në shqyrtim shkaqet e parashtruara në rekurs dhe ju ka thënë përgjigje pretendimeve të kërkueses.

8. **Subjekti i interesuar Banka e Shqipërisë** ka paraqitur parashtrime me shkrime duke argumentuar si vijon:

8.2 Për pretendimin e cenimit të së drejtës së njoftimit pretendimi i kërkueses është i pabazuar pasi Gjykata e Lartë ka zbatuar mënyrën e njoftimit të parashikuar në ligj.

8.3 Pretendimi për gjykimin nga një gjykatë e caktuar me ligj është tërësisht i pabazuar, pasi Gjykata e Lartë nuk ka riçelur hetimin gjyqësor dhe nuk ka marrë prova të reja, por është bazuar në provat e sjella nga palët gjatë gjykimeve në shkallë të parë.

8.4 Për pretendimin e cenimit të parimit të arsytimit të vendimit gjyqësor rezulton se vendimi i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë i përmbush standardet kushtetuese të parimit të arsytimit.

III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimitimin e kërkueses

9. Gjykata vlerëson se kërkuesja, shoqëria “Gen-Red” sh.p.k., legjitimohet *ratione personae*, pasi është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e regjistruar si person juridik me vendimin e datës 1.2.1999 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, si dhe *ratione temporis*, pasi kërkesa është paraqitur brenda afatit 2-vjeçar të parashikuar nga neni 30/2 e ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”. Lidhur me legjitimitimin *ratione materiae*, kërkuesja ka kërkuar shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën të vendimit të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, duke pretenduar cenimin e së drejtës për një proces të rregullt ligjor në aspektin e së drejtës së njoftimit, të parimit të gjykimit nga një gjykatë e caktuar me ligj dhe të arsytimit të vendimit gjyqësor.

B. Për pretendimin e cenimit të së drejtës për të marrë pjesë në gjykim

10. Kërkuesja ka pretenduar se nuk ka marrë dijeni për zhvillimin e gjykimit në Gjykatën e Lartë, për rrjedhojë i është mohuar e drejta për t’u dëgjuar. Gjithashtu ka pretenduar se nuk i është njoftuar rekursi i paraqitur nga Avokatura e Shtetit, duke mos pasur mundësi të paraqesë kundërrekurs.

11. Gjykata vëren se gjatë gjykimit Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë i është referuar ligjit nr. 49, datë 3.5.2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”. Subjekti i interesuar, Banka e Shqipërisë, ka paraqitur kërkesë për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë dhe Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 365, datë 31.10.2013, ka vendosur pranimin e kërkesës për



pezullimin e ekzekutimit të vendimit. Gjykata e Lartë është vënë në lëvizje me rekursin e subjektit tjetër të interesuar, Zyrës Vendore të Avokaturës së Shtetit Tiranë, në datën 17.2.2012 dhe çështja është regjistruar në datën 20.4.2012. Një kopje e rekursit i është njoftuar Bankës së Shqipërisë dhe avokatit. N.K., i cili e ka përfaqësuar me autorizim kërkuesen gjatë gjykimit në Gjykatën e Apelit Tiranë. Dëftesa e komunikimit të rekursit mban datën 2.4.2012 dhe është nënshkruar në datën 5.4.2012 nga avokati E.K. Nga dosja gjyqësore rezulton se rekursi i është njoftuar përfaqësuesit të kërkueses, i cili nuk rezulton të ketë paraqitur kundërrekurs.

12. Në ligjin nr. 49, datë 3.5.2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative” është parashikuar, mes të tjerash, edhe procedura e gjykimit të çështjeve të kësaj natyre. Sipas nenit 59 të ligjit nr. 49/2012 pala kundër së cilës është bërë rekurs mund të kundërshtojë pretendimet e ngritura në rekurs brenda 15 ditëve nga komunikimi i rekursit dhe mosparaqitja e kundërrekursit brenda këtij afati sjell humbjen e së drejtës për të paraqitur pretendimet në një fazë të mëvonshme në Gjykatën e Lartë. Sipas nenit 60 të ligjit dërgimi i dosjes së gjykimit në Gjykatën e Lartë bëhet brenda 10 ditëve nga data e përfundimit të komunikimeve të rekursit e të kundërrekursit palëve ndërgjyqëse në proces. Për sa i përket shqyrtimit të rekursit në Gjykatën e Lartë, në nenin 61 të ligjit parashikohet se ai bëhet, si rregull, mbi bazë dokumentesh në dhomë këshillimi. Për efekt të gjykimit gjyqtari relator cakton datën dhe orën për shqyrtimin e çështjes në dhomë këshillimi, duke urdhëruar njoftimin e palëve. Sekretaria e gjykatës njofton me shpallje ditën dhe orën e shqyrtimit të rekursit, si dhe përbërjen e trupit gjykues të paktën 21 ditë përpara. Po ashtu, në nenin 62 të ligjit janë parashikuar edhe rastet kur çështja shqyrtohet në seancë gjyqësore me praninë e palëve.

13. Gjykata konstaton se çështja ka nisur për gjykim nga Kolegjit Civil i Gjykatës së Lartë. Me miratimin e ligjit për krijimin e gjykatave administrative, çështja i ka kaluar Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, i cili në datën 4.5.2015 ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim në dhomë këshillimi në datën

28.5.2015, duke urdhëruar sekretarinë e gjykatës të bëjë njoftimin e palëve për orën dhe ditën e caktuar. Bazuar në procesverbalin e seancës gjyqësore, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë është shprehur se palët kanë marrë dijeni rregullisht me anë të shpalljes publike të datës 6.5.2015 dhe në vijim Kolegji është shprehur për pranueshmërinë e rekursit, duke vendosur ndryshimin e vendimit nr. 259, datë 24.1.2011 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe të vendimit nr. 154, datë 25.1.2012 të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe rrëzimin e padisë.

14. Gjykata në jurisprudencën e saj ka theksuar dallimin mes shqyrtimit të rekursit në dhomë këshillimi, sipas nenit 480 të KPC-së, si fazë paraprake ku vlerësohet plotësimi ose jo i kriterëve për kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë gjyqësore, dhe shqyrtimit të çështjeve në seancë gjyqësore mbi bazë dokumentesh, sipas ligjit nr. 49/2012. Megjithëse në shqyrtimin e çështjeve administrative Gjykata e Lartë, përgjithësisht, procedon me shqyrtimin jo në seancë publike me praninë e palëve, por në dhomë këshillimi mbi bazën e dokumenteve të paraqitura, kjo nuk nënkupton se ky lloj gjykimi përjashton detyrimin për njoftimin e rregullt të palëve në mënyrë që të mbrohen në procesin gjyqësor ku janë palë me anë të paraqitjes së komenteve apo prapësimeve lidhur me pretendimet e palës që ka vënë në lëvizje gjykatën. Qëllimi i ligjvënësit në krijimin e gjykatave administrative ka qenë thjeshtëtimi i procedurave me objekt zgjidhjen e mosmarrëveshjeve administrative, por duke garantuar mbrojtjen efektive të të drejtave subjektive dhe interesave të ligjshëm të personave nëpërmjet një procesi të rregullt gjyqësor dhe brenda afateve të shpejta e të arsyeshme (*shih vendimet nr. 59, datë 16.9.2016; nr. 29, datë 19.5.2016 të Gjykatës Kushtetuese*).

15. Gjykata thekson se Gjykata e Lartë ka detyrimin jo vetëm të njoftojë rregullisht palët për procesin, por edhe t’u sigurojë atyre mundësinë që të marrin pjesë në proces dhe të dëgjohen, qoftë edhe mbi bazën e dokumenteve. Për këtë qëllim Gjykata e Lartë duhet t’u garantojë palëve të drejtën që jo vetëm të njihen në kohë me pretendimet e palës tjetër, por edhe të kenë mundësinë që t’i kundërshtojnë ato apo të paraqesin argumentet e tyre për çështjen (*shih vendimin nr. 29, datë 19.5.2016 të Gjykatës Kushtetuese*).



16. Bazuar në standardet e mësipërme, Gjykata çmon se Gjykata e Lartë, pavarësisht nëse i shqyrton çështjet në seancë të hapur publike apo mbi bazë dokumentesh, ka detyrimin të verifikojë nëse palët në proces kanë marrë dijeni efektivisht për rekursin dhe procesin, me qëllim garantimin e së drejtës së mbrojtjes dhe barazisë së armëve në gjykim (*shih vendimet nr. 65, datë 7.11.2016; nr. 29, datë 19.5.2016; nr. 21, datë 4.4.2016 të Gjykatës Kushtetuese*). Për rrjedhojë, Gjykata vlerëson se pretendimi i kërkuësës se i është mohuar e drejta për të marrë pjesë në gjykim dhe për t'u dëgjuar është i bazuar.

17. Lidhur me pretendimet për cenimin e parimit të gjykimit nga një gjykatë e caktuar me ligj dhe parimit të arsytimit të vendimit gjyqësor, gjykata vlerëson të rezervohet të shprehet pasi çështja do të rishqyrtohet nga Gjykata e Lartë.

18. Si përfundim, Gjykata vlerëson se në çështjen konkrete Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë ka cenuar të drejtën për një proces të rregullt ligjor pasi kërkuësës nuk i është dhënë mundësia për të paraqitur argumentet e saj dhe të mbrohet kundër pretendimeve të palës kundërshtare.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 131/f dhe 134/1/i të Kushtetutës, si dhe të neneve 72 e vijues të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë” të ndryshuar, me shumicë votash,

VENDOSI:

- Pranimin e kërkesës.
- Shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën të vendimit nr. 00-2015-2877 (344), datë 28.5.2015 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë (dhomë këshillimi).
- Dërgimin e çështjes për rishqyrtim në Gjykatën e Lartë.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë pro: Bashkim Dedja (kryetar), Vitore Tusha, Vladimir Kristo, Besnik Imeraj, Gani Dizdari

Anëtarë kundër: Fatmir Hoxha, Fatos Lulo

MENDIM PAKICE

Në çështjen me kërkuese shoqërinë “Gen-Red” sh.p.k., shumica nëpërmjet arsytimit të saj ka konkluduar se kërkuësës i është cenuar e drejta për një proces të rregullt ligjor, pasi nuk ka marrë dijeni për zhvillimin e gjykimin në Gjykatën e Lartë, e si pasojë nuk ka paraqitur argumentet e saj.

Në ndryshim nga sa arsyeton shumica, ne gjyqtarët e pakicës nuk pajtohemi me përfundimin e arritur, sepse, në vlerësimin tonë, Gjykata e Lartë nuk i ka cenuar kërkuësës të drejtën për një proces të rregullt ligjor.

Sipas nenit 59 të ligjit nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, të ndryshuar, pala, kundër së cilës është bërë rekurs, mund të kundërshtojë pretendimet e ngritura në rekurs brenda 15 ditëve nga komunikimi i rekursit. Për sa i përket shqyrtimit të rekursit në Gjykatën e Lartë, neni 61 i ligjit parashikon se ai bëhet, si rregull, mbi bazë dokumentesh në dhomë këshillimi. Për efekt të gjykimit gjyqtari relator cakton datën dhe orën për shqyrtimin e çështjes në dhomë këshillimi, duke urdhëruar njoftimin e palëve dhe sekretaria e gjykatës njofton me shpallje ditën dhe orën e shqyrtimit të rekursit, si dhe përbërjen e trupit gjykues të paktën 21 ditë përpara. Po ashtu, ligji ka parashikuar edhe rastet kur çështja shqyrtohet në seancë gjyqësore me praninë e palëve (neni 62).

Ne gjyqtarët e pakicës vlerësojmë se Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë ka zbatuar rregullat e njoftimit të rekursit ndaj kërkuësës. Sikurse është parashtruar, Gjykata e Lartë është vënë në lëvizje me rekursin e subjektit tjetër të interesuar, Zyrës Vendore të Avokaturës së Shtetit Tiranë, në datën 17.2.2012 dhe një kopje e rekursit i është njoftuar Bankës së Shqipërisë dhe avokat Nexhdet Kambos, i cili ka përfaqësuar me autorizim kërkuësen gjatë gjykimit në Gjykatën e Apelit Tiranë. Dëftesa e komunikimit të rekursit mban datën 2.4.2012 dhe është nënshkruar në datën 5.4.2012 nga Avokat E. Kambo. Gjithashtu, subjekti i interesuar, Banka e Shqipërisë, ka paraqitur kërkesë për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë dhe Kolegji Civil i Gjykatës së



Lartë me vendimin nr. 365, datë 31.10.2013, ka vendosur pranimin e kërkesës për pezullimin e ekzekutimit të vendimit, vendim për të cilin kërkuesja ka marrë djeni. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë në datën 4.5.2015, ka vendosur kalimin e çështjes për gjykim në dhomën e këshillimit për në datën 28.5.2015 duke urdhëruar sekretarinë e gjykatës të bëjë njoftimin e palëve për orën dhe ditën e caktuar. Bazuar në procesverbalin e seancës gjyqësore, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë është shprehur se palët kanë marrë djeni rregullisht me anë të shpalljes publike të datës 6.5.2015.

Bazuar në rrethanat e çështjen konkrete, Gjykata nuk duhej të kishte vendosur shfuqizimin e vendimit të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë për pretendimin e cenimit të së drejtës për të marrë djeni për zhvillimin e gjykimit, për sa kohë që është arritur të provohet se Gjykata e Larta ka respektuar rregullat procedurale për njoftimin.

Për të gjitha argumentet e mësipërme vlerësojmë se kërkesa duhej të rrëzohej pasi kërkueses nuk i është cenuar e drejta për një proces të rregullt ligjor, në këndvështrim të njoftimit të gjykimit nga Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë.

Anëtarë: Fatmir Hoxha, Fatos Lulo

VENDIM
Nr. 18, datë 6.3.2017

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Bashkim Dedja	kryetar i	Gjykatës Kushtetuese
Vladimir Kristo	anëtar i	“ “
Vitore Tusha	anëtare e	“ “
Fatmir Hoxha	anëtar i	“ “
Gani Dizdari	anëtar i	“ “
Fatos Lulo	anëtar i	“ “
Besnik Imeraj	anëtar i	“ “

me sekretare Edmira Babaj, në datat 21.7.2016, 20.9.2016 dhe 12.10.2016 mori në shqyrtim në seancë plenare, mbi bazë dokumentesh, çështjen me nr. 47/2 Akti, që i përket:

KËRKUES: Lulzim Caka

SUBJEKT I INTERESUAR: Prokuroria e Përgjithshme

OBJEKTI: Shfuqizimi si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë i vendimeve nr. 15, datë 19.12.2012 të Gjykatës së Apelit Vlorë; nr. 00-2015-2122, datë 28.4.2015 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.

BAZA LIGJORE: Nenet 42, pikat 1 dhe 2, 131/f dhe 134/1/i të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; nenet 1/5 dhe 6 të Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut dhe neni 4 i protokollit nr. 7 të Konventës; nenet 27, 28, 29, 30, 39, 42 dhe vijues të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Besnik Imeraj, mori në shqyrtim pretendimet me shkrim të përfaqësuesit të kërkuesit, i cili ka kërkuar pranimin e kërkesës, prapësimet me shkrim të subjektit të interesuar, Prokurorisë së Përgjithshme, që ka kërkuar rrëzimin e kërkesës, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

1. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier, me vendimin nr. 175, datë 11.5.2000, ka vendosur: “*Deklarimin fajtor të të gjykuarit Lulzim Caka për kryerjen e veprës penale “Vrasje me dashje” të parashikuar nga neni 76 i Kodit Penal dhe dënimin e tij me 20 (njëzet) vite burgim. Deklarimin fajtor të të gjykuarit Lulzim Caka për kryerjen e veprës penale “Vrasje në rrethana të tjera cilësuese” e kryer në bashkëpunim, mbetur në tentativë, parashikuar nga nenet 79/c, 22 dhe 25 të Kodit Penal dhe dënimin e tij me 25 (njëzet e pesë) vite burgim. Deklarimin fajtor të të gjykuarit Lulzim Caka për kryerjen e veprës penale “Mbajtje pa leje të armëve luftarake” të parashikuar nga neni 278/2 i Kodit Penal dhe dënimin e tij me 2 (dy) vite burgim. Në bashkim të dënimeve, në zbatim të nenit 55/1 të Kodit Penal, e dënon të gjykuarin Lulzim Caka përfundimisht me 25 (njëzet e pesë) vite burgim.”*

2. Gjykata e Apelit Vlorë, me vendimin nr. 174, datë 20.10.2000, ka vendosur: “*Lënien në fuqi të vendimit penal nr. 175, datë 11.5.2000 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier.”*

3. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 572, datë 16.10.2001 ka vendosur mospranimin e rekursit të paraqitur.



4. Kundër këtyre vendimeve kërkuesi ka paraqitur kërkesë në Gjykatën Kushtetuese. Me vendimin nr. 200, datë 18.11.2003, Kolegji i Gjykatës Kushtetuese ka vendosur: *“Moskalimin e çështjes në seancë plenare, duke e deklaruar jashtë juridiksionit të saj çështjen.”*

5. Pas shterimit të mjeteve të brendshme të ankimit, kërkuesi i është drejtuar me kërkesë Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ), e cila, me vendimin e datës 8.12.2009, ka vendosur: *“1. Deklaron ankesat në lidhje me nenin 6 të Konventës të pranueshme... 2. Vlerëson se nuk ka pasur shkelje të nenit 6 § 1 në lidhje me nenin 6 § 3 (c) të Konventës në lidhje me mungesën e aksesit të një mbrojtësi gjatë disa momenteve të gjyqimit. 3. Vlerëson se nuk ka pasur shkelje të nenit 6 § 1 në lidhje me nenin 6 § 3 (d) të Konventës sa i takon refuzimit të gjykatës për të lejuar aplikantin të pyeste dëshmitarin M. 4. Vlerëson se ka pasur shkelje të nenit 6 § 1 në lidhje me nenin 6 § 3 (d) të Konventës sa i takon dështimit për të siguruar paraqitjen në procesin gjyqësor të aplikantit të dëshmitarëve O., Q. dhe S. 5. Vlerëson se ka pasur shkelje të nenit 6 § 1 në lidhje me nenin 6 § 3 (d) të Konventës sa i takon dështimit për të marrë parasysh dëshmitë e katër dëshmitarëve të dhëna në favor të aplikantit përpara Gjykatës së Beratit. 6. Vlerëson se ka pasur shkelje të nenit 6 § 1 në lidhje me nenin 6 § 3 (d) të Konventës sa i takon dështimit për të siguruar paraqitjen në procesin gjyqësor të aplikantit të dëshmitarëve B., C. dhe D.”*

6. Pas këtij vendimi kërkuesi i është drejtuar Gjykatës së Lartë me kërkesë për rishikimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2012-750 (75), datë 7.3.2012, ka vendosur: *“Të pranohet kërkesën për rishikim, duke vendosur prishjen e vendimit nr. 498, datë 12.10.2001 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë dhe të vendimit nr. 174, datë 20.10.2000 të Gjykatës së Apelit Vlorë dhe dërgimin e çështjes për rigjykim në Gjykatën e Apelit Vlorë, me tjetër trup gjyqësor.”*

7. Gjykata e Apelit Vlorë, me vendimin nr. 15, datë 19.12.2012, ka vendosur: *“Lënien në fuqi të vendimit penal nr. 175, datë 11.5.2000 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier.”*

8. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2015-2122, datë 28.4.2015, ka vendosur: *“Mospranimin e rekursit të ushtruar nga i dënuari Lulzim Caka.”*

II

9. **Kërkuesi Lulzim Caka** i është drejtuar Gjykatës për shfuqizimin e vendimeve të marra për çështjen pas kthimit të saj për rigjykim nga Gjykata e Lartë dhe parashtron në mënyrë të përmbledhur këto shkaqe:

9.1 Detyrat për gjykatat shqiptare GJEDNJ-ja nuk i ka lënë evazive, por detyruese. Në kushtet kur nga GJEDNJ-ja janë konstatuar shkelje të së drejtës për një proces të rregullt ligjor ndaj kërkuetit, ky fakt nuk mund të vihet në diskutim. Gjykata e Apelit Vlorë nuk ka marrë parasysh konkluzionet dhe detyrat e lëna nga GJEDNJ-ja dhe Gjykata e Lartë në vendimin për pranimin e kërkesës për rishikim.

9.2 Në rigjykimin e çështjes është cenuar parimi i prezumimit të pafajësisë. Në lidhje me episodin e datës 18.3.1998, ku ka mbetur i vrarë shtetasi Xh.Ç., rrethanat dhe faktet flasin ndryshe në raport me arsyetimet e gjykatave që japin fajësi pa asnjë provë të verifikuar apo të marrë në seancë gjyqësore. Gjykata e Apelit mbajti në vendimin e saj një qëndrim të kundërt, duke mos iu referuar konstatimeve të GJEDNJ-së dhe detyrave të lëna nga Gjykata e Lartë. Kjo rezultoi edhe nga provat e administruara nga gjykata gjatë procesit, si dëshmitë e dhëna nga ish-shëfë i komisariatit të policisë Berat, procesverbali i vendit të ngjarjes, deklarata e mjekut oksigjenist dhe raporti mjeko-ligjor.

9.3 Sot dosja penale dhe tërësia e akteve që ndodhen në këtë fashikull nuk janë në gjendjen që ka qenë fashikulli kur është dhënë vendimi i fajësisë nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier, pasi ndodhemi para kushteve dhe rrethanave krejt ndryshe të provave dhe akteve, sipas vlerësimit të bërë nga GJEDNJ-ja në vendimin e datës 18.12.2012. Nga ana tjetër, Gjykata e Lartë në vendimin e rishikimit, bazuar në vendimin e GJEDNJ-së, ka çelur rrugën për një zgjidhje të drejtë në themel të kësaj çështje, pasi ajo jo vetëm që nuk ka lënë vend për të dyshuar lidhur me pafajësinë e kërkuetit, por as nuk e ka vënë në diskutim atë.

9.4 GJEDNJ-ja në analizë të episodit në ngjarjen e datës 18.3.1998, ku është vrarë shoku i kërkuetit, shtetasi Xh.Ç., duke parë që nga katër dëshmitarë të akuzës vetëm dy nga ata dëshmojnë për fajësinë e kërkuetit, të dy në



poste drejtuese të policisë, i merr me rezerva thëniet e tyre dhe duke i parë me provat e tjera vë në dyshim vërtetësinë dhe provueshmërinë e akuzës lidhur me veprën e atribuuar të parashikuar në nenet 79/ç-22 dhe 25 të KP-së. GJEDNJ-ja dhe Gjykata e Lartë marrin dhe çmojnë si provë në favor të kërkuesit edhe deklaratën noteriale të depozituar në Strasburg në vitin 2003, të lëshuar nga ish-kryetari i trupit gjykues të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat, sipas së cilës transferimi i dosjes është bërë në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Fier kur trupi gjykues ishte në mbyllje të shqyrtimit gjyqësor dhe në kohën kur kishte krijuar bindjen se nuk kishte prova të mjaftueshme kundër kërkuesit.

9.5 Lidhur me akuzën për veprën penale të parashikuar nga nenet 79/c-25, 22 dhe 278/2 të KP-së, Gjykata e Lartë i kishte lënë detyrë Gjykatës së Apelit pyetjen e ish-policëve pjesë operationale të postbllokut të ngjarjes së datës 18.3.1998, por me gjithë përpjekjet u bë e mundur vetëm pyetja e dëshmitarit S.C., dëshmi që shkoi në favor të pafajësisë së kërkuesit. Në favor të kërkuesit shkon edhe mosardhja dhe mosparaqitja e dy ish-policëve të tjerë.

9.6 Lidhur me akuzën për veprën penale të parashikuar në nenin 76 të KP-së, që bën fjalë për vrasjen e shtetasit P.E., GJEDNJ-ja dhe Gjykata e Lartë kanë vënë në dyshim procesin e të provuarit. Referuar dëshmimeve të dëshmitarëve të dhëna në fazën e hetimeve paraprake, sepse nuk u arritën të pyeten gjatë rigjyqimit, ata nuk tregojnë asgjë konkrete për ngjarjen e datës 21.7.1997 kundër kërkuesit dhe këto deklarime shkojnë në favor të tij.

9.7 Gjykata e Lartë duke mos pranuar rekursin për shqyrtim në seancë gjyqësore, si dhe duke mos e arsyetuar atë ka legjitimuar shkeljet e konstatuara në gjykatat më të ulëta, si dhe ka vepruar në kundërshtim me vendimarrjen e mëparshme të saj.

10. **Subjekti i interesuar, Prokuroria e Përgjithshme**, ka prapësuar me shkrim para Gjykatës, në mënyrë të përmbledhur, sa më poshtë vijon:

10.1 Nga ana e Gjykatës së Apelit Vlorë janë bërë të gjitha përpjekjet për njoftimin e dëshmitarëve, njëri prej të cilëve ka ndërruar jetë, ndërsa të tjerët, me gjithë përpjekjet e gjykatës, nuk ka qenë e mundur të njoftohen, pasi

ndodhen jashtë shtetit. Në këto kushte, me miratimin edhe të mbrojtjes së kërkuesit, me të drejtë gjykata ka vendosur revokimin e vendimit për thirrjen e tyre, pasi ka qenë e pamundur që të realizohej kjo detyrë e lënë nga Gjykata e Lartë.

10.2 Pretendimi për cenimin e parimit të prezumimit të pafajësisë është i pabazuar. Gjykata e Apelit Vlorë, në arsyetimin e vendimit të saj me të cilin kërkuesi është deklaruar fajtor për kryerjen e veprave penale për të cilat akuzohej, është shprehur në lidhje me të gjitha provat shkresore dhe ato me dëshmitarë të administruara në gjykim, duke analizuar secilën prej tyre.

10.3 Pretendimi se Gjykata e Apelit Vlorë hodhi poshtë konkluzionet e Gjykatës së Strasburgut dhe detyrat e lëna nga Gjykata e Lartë dhe se zbatimi i tyre duhej të kryhej në mënyrën më efikase të mundshme nuk qëndron dhe nuk është i mbështetur në aktet bashkëlidhur të kërkesës.

10.4 Pretendimi kryesor i ngritur nga kërkuesi ka të bëjë me cenimin e së drejtës për një proces të rregullt ligjor si pasojë e moszbatimit të vendimit të GJEDNJ-së në favor të tij, por në fakt rezulton se detyrat e lëna nga Gjykata e Lartë në zbatim të vendimit të GJEDNJ-së janë realizuar nga Gjykata e Apelit Vlorë.

10.5 Në rastin në gjykim nuk konstatohet cenimi i së drejtës së aksesit në Gjykatën e Lartë. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë në përputhje me kompetencat e tij ligjore, pasi ka marrë për shqyrtim shkaqet e paraqitura në rekurs, i ka dhënë përgjigje kërkuesit lidhur me to. Edhe për sa i përket arsyetimit të kufizuar të vendimeve të dhomës së këshillimit, Gjykata Kushtetuese ka vlerësuar se kërkesat e një procesi të rregullt ligjor mund të plotësohen edhe me një arsyetim të kufizuar.

III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimitimin e kërkuesit

11. Gjykata vlerëson se kërkuesi legjitimohet *ratione personae* në lidhje me pretendimet e tij, të cilat i ka paraqitur në kërkesë, në kuptim të neneve 131/f dhe 134/1/i të Kushtetutës dhe *ratione temporis*, pasi kërkesa është paraqitur në Gjykatën Kushtetuese brenda afatit të parashikuar nga ligji nr. 8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe



funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”. Kërkuesi legjitimohet edhe *ratione materiae*, pasi pretendimet e tij *prima facie* janë të tilla që bëjnë pjesë në juridiksionin kushtetues.

B. Për pretendimin se gjatë rigjyqimit të çështjes nuk janë marrë parasysh detyrat dhe konkluzionet e lëna nga GJEDNJ-ja dhe Gjykata e Lartë, si dhe për cenimin e parimit të prezumimit të pafajësisë

12. Sipas kërkuesit, Gjykata e Apelit Vlorë në rigjykimin e çështjes nuk ka zbatuar detyrat e lëna nga GJEDNJ-ja dhe Gjykata e Lartë, të cilat ishin detyruese në rigjykimin e çështjes. Në kushtet kur nga GJEDNJ-ja janë konstatuar shkelje të së drejtës për një proces të rregullt ligjor në procesin penal të zhvilluar ndaj kërkuesit, ky fakt nuk mund të vihej në diskutim. Gjykata e Lartë në vendimin e rishikimit, bazuar në vendimin e GJEDNJ-së, ka çelur rrugën për një zgjidhje të drejtë në themel të kësaj çështje, pasi ajo jo vetëm që nuk ka lënë vend për të dyshuar lidhur me pafajësinë e kërkuesit, por as nuk e ka vënë në diskutim atë. GJEDNJ-ja në analizë të episodit në ngjarjen e datës 18.3.1998, duke parë që nga katër dëshmitarë të akuzës vetëm dy nga ata dëshmojnë për fajësinë e kërkuesit, të dy në poste drejtuese të policisë, i merr me rezerva thëniet e tyre dhe vë në dyshim vërtetësinë dhe provueshmërinë e akuzës lidhur me veprën e atribuuar të parashikuar në nenet 79/ç-22 dhe 25 të KP-së. GJEDNJ-ja dhe Gjykata e Lartë marrin dhe çmojnë si provë në favor të kërkuesit edhe deklaratën noteriale të depozituar në Strasburg në vitin 2003, të lëshuar nga ish-kryetari i trupit gjykues të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat. Lidhur me akuzën për veprën penale të parashikuar nga nenet 79/c-25, 22 dhe 278/2 të KP-së, Gjykata e Lartë i kishte lënë detyrë Gjykatës së Apelit pyetjen e ish- policëve pjesë operationale të postbllokut të ngjarjes së datës 18.3.1998, por me gjithë përpjekjet u bë e mundur vetëm pyetja e dëshmitarit S.C., dëshmi që shkoi në favor të pafajësisë së kërkuesit. Në favor të kërkuesit shkon edhe mosardhja dhe mosparaqitja e dy ish-policëve të tjerë. Lidhur me akuzën për veprën penale të parashikuar në nenin 76 të KP-së, që bën fjalë për vrasjen e shtetasit P.E., GJEDNJ-ja dhe Gjykata e Lartë kanë vënë në dyshim procesin e të provuarit. Referuar dëshmimeve të dëshmitarëve të dhëna në fazën e hetimeve paraprake, sepse nuk u arritën të pyeten gjatë rigjyqimit, ata nuk tregojnë asgjë konkrete për ngjarjen e datës 21.7.1997 kundër

kërkuesit dhe këto deklarime shkojnë në favor të tij. Për rrjedhojë, në rigjykimin e çështjes është cenuar parimi i prezumimit të pafajësisë, pasi Gjykata e Apelit mbajti në vendimin e saj një qëndrim të kundërt, duke mos iu referuar konstatimeve të GJEDNJ-së dhe detyrave të lëna nga Gjykata e Lartë.

13. Gjykata, në interpretim të neneve 5, 116, 122 dhe 17/2 të Kushtetutës, duke vënë theksin në statusin e veçantë që ka Konventa Europiane për të Drejtat e Njeriut në rendin e brendshëm ligjor, ka njohur kompetencën ekskluzive të GJEDNJ-së në sistemin tonë juridik dhe efektin e drejtpërdrejtë të vendimeve të saj në interpretimin e standardeve kushtetuese të të drejtave të njeriut, veçanërisht atyre që i referohen së drejtës për një proces të rregullt ligjor, e sanksionuar në nenin 42 të Kushtetutës. Vendimet e GJEDNJ-së kanë vlerën e tyre në dy aspekte, që lidhen me natyrën detyruese që rrjedh nga nenet 1 dhe 46 të Konventës dhe me mënyrën e zbatimit të tyre në sistemin e brendshëm. GJEDNJ-ja ka sqaruar parimet që rregullojnë zbatimin e vendimeve të saj, duke i vënë theksin zbatimit efektiv të këtyre vendimeve (*vendimi në çështjen Verein Gegen Tierfabriken Schweiz (VgT) kundër Zvicrës (nr. 2), datë 30.6.2009*). Sipas kërkesave të nenit 46 të KEDNJ-së një shtet palë për të cilin GJEDNJ-ja është shprehur se ka shkelur Konventën ose Protokollet e saj ka detyrimin që të veprojë në përputhje me vendimin e asaj Gjykate. Me fjalë të tjera, një dështim tërësor ose i pjesshëm i ekzekutimit të vendimit të GJEDNJ-së lind përgjegjësinë ndërkombëtare të shtetit. Shteti në fjalë ka detyrimin jo vetëm të shlyejë dëmin material ndaj personave të interesuar, por edhe të marrë masa individuale dhe/ose, nëse është e përshtatshme, masa të përgjithshme në rendin e vet ligjor, që t'i japë fund shkeljes së gjetur nga Gjykata dhe të rregullojë pasojat e shkeljes, me qëllimin që kërkuesi të rikthehet, për aq sa është e mundur, në gjendjen që ishte para se të bëhej shkelja (*vendimi në çështjen Scozzari dhe Giunta kundër Italisë, nr. 39221/98 dhe 41963/98, § 249, ECHR 2000-VIII, dhe Assanidze kundër Gjeorgjisë, nr. 71503/01, § 198, ECHR 2004-II*). Në vendimet e saj GJEDNJ-ja ka shprehur parimin e njohur të së drejtës ndërkombëtare *restitutio in integrum*, i cili është përdorur shpesh nga Komiteti i Ministrave në rezolutat e tij. Edhe pse në lidhje me mënyrën se si



do të zbatojnë detyrimet e parashikuara në nenin 46 të Konventës për ekzekutimin e vendimeve të GJEDNJ-së, shtetet palë të Konventës gëzojnë diskrecion dhe Konventa nuk përmban dispozita që t'u imponojë Palëve Kontraktuese detyrimin për të parashikuar në ligjin e brendshëm rishqyrtimin apo rihapjen e procedimeve, ekzistenca e mundësive të tilla, në rrethana të veçanta, ka provuar të jetë e rëndësishme dhe në disa raste i vetmi mjet për të arritur *restitutio in integrum* (shih vendimin nr. 45, datë 1.11.2013 të Gjykatës Kushtetuese).

14. Gjykata ka theksuar se gjyqtarët e çdo niveli zbatojnë drejtpërsëdrejti vendimet e GJEDNJ-së, në përputhje me nenin 122 të Kushtetutës dhe nenet 19 dhe 46 të KEDNJ-së, pasi respektimi i KEDNJ-së dhe standardeve kushtetuese është detyrim jo vetëm i kësaj Gjykate, por edhe i gjykatave të juridiksionit të zakonshëm, në mënyrë të veçantë i Gjykatës së Lartë, për shkak të kompetencave të veçanta të saj të natyrës rishikuese, por edhe në drejtim të unifikimit të praktikës gjyqësore. Roli i një gjykate të lartë është pikërisht zgjidhja e konflikteve, shmangia e divergjencave dhe qëndrueshmëria (shih vendimin nr. 20, datë 1.6.2011 të Gjykatës Kushtetuese). Për sa i përket legjislationit procedural civil, në ndryshim nga ai procedural penal, në vendin tonë janë bërë ndryshime të nevojshme, ku neni 494 i KPC-së është përcaktuar si një nga rastet kur pala e interesuar mund të kërkojë rishikimin e një vendimi që ka marrë formë të prerë, edhe kur Gjykata Europiane gjen shkelje të KEDNJ-së. Në këto kushte, veç kërkesës për plotësimin e legjislationit procedural penal, Gjykata ka vlerësuar se Gjykata e Lartë duhet të gjejë zgjidhjen për të vënë në vend të drejtën e shkelur të kërkuesit me qëllim arritjen e *restitutio in integrum* (shih vendimet nr. 22, datë 9.3.2010 të Mbledhjes së Gjyqtarëve; nr. 20, datë 1.6.2011 të Gjykatës Kushtetuese).

15. Gjykata vëren se kërkuesi, pas përfundimit të procesit gjyqësor në Shqipëri, i është drejtuar GJEDNJ-së duke pretenduar cenimin e së drejtës për një proces të rregullt ligjor, të garantuar nga 6 i Konventës. Në vendim GJEDNJ-ja gjeti disa shkelje të kësaj dispozite, konkretisht ato që lidhen me dështimin për të siguruar paraqitjen në procesin gjyqësor të disa dëshmitarëve dhe për të marrë parasysh dëshmitë e katër dëshmitarëve të dhëna në favor të kërkuesit përpara Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat. Pas këtij vendimi kërkuesi i është

drejtuar Gjykatës së Lartë me kërkesë për rishikim, e cila në zbatim edhe të vendimit të GJEDNJ-së ka lënë disa detyra konkrete për gjykatën e rigjykimit, konkretisht të marrë në konsideratë disa dëshmi të administruara në gjykimin në fakt, si edhe të thërrasë dhe të pyesë në gjykim disa shtetas të tjerë, me qëllim korrigjimin e shkeljeve të konstatuara nga GJEDNJ-ja.

16. Gjykata vëren se gjatë rigjykimit të çështjes në Gjykatën e Apelit Vlorë ajo ka vendosur përsëritjen e pjeshme të hetimit gjyqësor me qëllim zbatimin e detyrave e lëna nga Gjykata e Lartë, si dhe respektimin e vendimit të GJEDNJ-së. Gjykata e Apelit në shqyrtimin e çështjes ka marrë në analizë dhe ka vlerësuar në tërësinë e tyre të gjitha provat e administruara në gjykatën e faktit, si dhe ka bërë përpjekjet për të njoftuar për t'u paraqitur në gjykim disa dëshmitarë. Konkretisht nga vendimi i Gjykatës së Apelit rezulton se janë vlerësuar dhe marrë në konsideratë edhe dëshmitë e shtetasve N.Ç., A.D., G.D. dhe L.C. për ngjarjen e datës 18.3.1998, sipas detyrës së lënë nga Gjykata e Lartë, dëshmi të cilat janë vlerësuar si prova të besueshme vetëm për atë pjesë e cila përputhet me provat e tjera të administruara në gjykim. Gjykata e Apelit ka vlerësuar, gjithashtu, edhe deklaratën e shtetasit B.H., kryesues i trupit gjykues në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Berat, të paraqitur nga kërkuesi si provë para GJEDNJ-së.

17. Për sa i përket pyetjes së dëshmitarëve S.C., A.M. dhe S.D., për të cilët nuk është bërë e mundur pyetja në gjykatën e shkallës së parë, gjatë rigjykimit u bë e mundur vetëm pyetja e dëshmitarit S.C. Në lidhje me dëshmitarët e tjerë A.M. dhe S.D., Gjykata e Apelit, me gjithë përpjekjet e saj, nuk arriti njoftimin dhe pyetjen e tyre, pasi nga aktet rezulton se shtetasi S.D. është larguar jashtë shtetit në Itali, kurse për shtetasin A.M. nuk ka asnjë njoftim në lidhje me vendndodhjen apo vendbanimin e tij nga të dhënat e disponueshme nga institucionet shtetërore. Në këto kushte gjykata ka vendosur revokimin e vendimit për thirrjen e tyre si dëshmitarë në pamundësi absolute të realizimit të kësaj detyre të përcaktuar nga Gjykata e Lartë. Po ashtu, në lidhje me ngjarjen e datës 21.7.1997, Gjykata e Apelit rezon që të jenë bërë të gjitha përpjekjet për njoftimin dhe thirrjen në gjykim si dëshmitarë të shtetasve T.T., A.S. dhe A.K., por nga aktet rezulton se shtetasi A.K. ndodhet jashtë shtetit në Greqi, shtetasi A.S.



ndodhet në Turqi, kurse shtetasi T.T. ka ndërruar jetë. Për pasojë, mbështetur edhe në kërkimet e mbrojtjes dhe të prokurorit, gjykata ka vendosur revokimin e vendimit të ndërmjetëm për thirrjen e tyre në pamundësi të realizimit të kësaj detyre të caktuar nga Gjykata e Lartë.

18. Në kuptim të sa më sipër, Gjykata vlerëson se në rigjykimin e çështjes penale ndaj kërkuesit Lulzim Caka Gjykata e Apelit Vlorë ka zbatuar detyrimet që rrjedhin nga vendimi i GJEDNJ-së, si edhe detyrat e lëna nga Gjykata e Lartë në zbatim të tij. Ajo e ka bazuar vendimmarrjen në të gjitha provat e administruara në gjykimin në fakt, si edhe ato të administruara gjatë rigjyimit, duke i vlerësuar në harmoni me njëra-tjetrën, si dhe duke dhënë arsyet për qëndrimin e arritur prej saj.

19. Për rrjedhojë, Gjykata e Apelit Vlorë nuk ka cenuar as parimin e prezumimit të pafajësisë, sipas të cilit çdo dyshim shkon në favor të të pandehurit dhe barra e provës bie kryesisht mbi organin e akuzës. Gjykata e ka interpretuar prezumimin e pafajësisë në kuptimin që gjykatat e zakonshme nuk duhet ta fillojnë procesin me bindjen se i pandehuri e ka kryer krimin për të cilin akuzohet, se barra e provës i takon palës akuzuese, se çdo dyshim duhet të shkojë në favor të të pandehurit dhe se gjykata duhet ta mbështesë vendimin në prova të drejtpërdrejta dhe të tërthorta që duhet të provohen nga akuza (*shih vendimin nr. 68, datë 14.11.2016 të Gjykatës Kushtetuese*). Parimi i prezumimit të pafajësisë kërkon që deklarimi i fajësisë të së pandehurit të bëhet nga gjykata vetëm pas një shqyrtimi të plotë të çështjes, në përputhje me parimin e kontradiktoritetit dhe të barazisë së armëve në gjykim. Ky parim buron nga parimi i shtetit të së drejtës dhe është i lidhur ngushtë me të drejtën e personit të akuzuar për t'u mbrojtur në një gjykim të drejtë. Sipas këtij parimi asnjë masë që barazohet me dënimin nuk mund të jepet ndaj një të pandehuri pa u provuar fajësia e tij përtej çdo dyshimi të arsyeshëm (*shih vendimin nr. 68, datë 14.11.2016 të Gjykatës Kushtetuese*).

20. Edhe pse në rigjykim nuk është bërë e mundur të dëgjohen disa nga dëshmitarët, thirrja e të cilëve ishte lënë detyrë për gjykatën, nuk rezulton që Gjykata e Apelit Vlorë të ketë nisur procesin me bindjen se kërkuesi është fajtor për veprën penale për të cilën akuzohet. Po ashtu nuk rezulton se provave dhe dëshmive të administruara në gjykatën e faktit t'u jetë dhënë

një vlerë e paracaktuar, por ato janë vlerësuar në gjykim së bashku dhe në unitet me provat e tjera të administruara në proces. Për rrjedhojë, Gjykata vlerëson se këto pretendime të kërkuesit janë të pabazuara.

C. Për pretendimin për procesin e zhvilluar në Gjykatën e Lartë

21. Sipas kërkuesit, Gjykata e Lartë duke mos pranuar rekursin për shqyrtim në seancë gjyqësore, si dhe duke mos e arsyetuar atë ka legjitimuar shkeljet e konstatuara në gjykatat më të ulëta, si dhe ka vepruar në kundërshtim me vendimmarrjen e mëparshme të saj.

22. Gjykata vëren se në nenin 432 të KPP-së janë parashikuar shkaqet për të cilat mund të paraqitet rekurs, kurse në nenin 433 të KPP-së parashikohet se rekursi nuk pranohet në qoftë se bëhet për shkaqe të ndryshme nga ato që lejon ligji dhe se mospranimi i tij vendoset nga Kolegji i Gjykatës së Lartë në dhomën e këshillimit, pa pjesëmarrjen e palëve. Në jurisprudencë konstante Gjykata ka theksuar se në rast se Kolegji në dhomën e këshillimit krijon bindjen se shkaqet e ngritura në rekurs janë haptazi të pabazuara, pasi nuk bëjnë pjesë në ato shkaqe që parashikon dispozita ligjore ose nuk gjejnë mbështetje në aktet e dosjes gjyqësore, atëherë është në funksionin e tij të vendosë, në pajtim me kërkesat ligjore, mospranimin e çështjes për shqyrtim në seancë gjyqësore. Veprimtaria seleksionuese e dhomës së këshillimit nuk është një shkelje e së drejtës së palëve për t'iu drejtuar gjykatës, por një veprimtari e domosdoshme në funksion të aksesit në gjykatë vetëm të atyre çështjeve që i parashikon ligji, duke lënë jashtë përzgjedhjes kërkesat e paarsyeshme dhe haptazi të pambështetura në ligj. Ky lloj shqyrtimi paraprak vlerësues është kompetencë vetëm e trupës së gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë në dhomë këshillimi dhe nuk mund të bëhet pjesë e kontrollit kushtetues që zhvillon Gjykata (*shih vendimin nr. 8, datë 26.2.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

23. Gjykata vlerëson se në rekurs, të paktën formalisht, palët përpiqen të ngrenë para Gjykatës së Lartë shkaqe nga ato të parashikuara nga dispozitat procedurale përkatëse dhe për këtë arsye shqyrtimi i çështjes nga dhoma e këshillimit e Gjykatës së Lartë nuk është vetëm një konstatim formal i paraqitjes së shkaqeve ligjore



në rekurs, por konsiston në vlerësimin e këtyre shkaqeve dhe bazueshmërisë së tyre, duke analizuar materialet e dosjes gjyqësore. Në rastet kur kolegji konstaton se shkaqet, pavarësisht nga mënyra e paraqitjes së tyre, kanë të bëjnë me vlerësimin e provave, bindjen e brendshme të gjykatave të shkallëve më të ulëta apo me shkaqe që objektivisht nuk ekzistojnë në dosjen gjyqësore, ka të drejtë të mos e pranojë rekursin. Kjo është edhe përgjigja që i jep Gjykata e Lartë pretendimeve të ngritura në rekurs nga palët (*shih vendimin nr. 52, datë 14.11.2014 të Gjykatës Kushtetuese*). Gjykata ka theksuar se kur janë të pranishme pretendime që kanë të bëjnë me shkëlqen e parimeve themelore të procesit gjyqësor, si dhe kur këto pretendime gjejnë pasqyrim në materialet e çështjes, atëherë vendimi i Kolegjit për mospranimin e rekursit vë në dyshim të drejtën për një proces të rregullt ligjor. Kjo sepse, referuar natyrës së gjykimit kushtetues të kërkesave individuale, kontrolli i respektimit të standardeve kushtetuese për një proces të rregullt ligjor është funksion edhe i gjykatave të zakonshme, për më tepër i Gjykatës së Lartë (*shih vendimin nr. 8, datë 26.2.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

24. Bazuar në standardet e mësipërme, Gjykata vlerëson se në rastin konkret Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, në përputhje me kompetencat e tij ligjore, pasi ka marrë në shqyrtim shkaqet e paraqitura në rekurs, i ka dhënë përgjigje kërkuarit se nuk janë të tilla nga ato që parashikon neni 432 i KPP-së. Për arsye edhe ky pretendim i kërkuarit është i pabazuar.

25. Në përfundim, Gjykata vlerëson se pretendimet e kërkuarit për cenimin e së drejtës për një proces të rregullt ligjor janë të pabazuara, për rrjedhojë kërkesa duhet të rrëzohet.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 131/f dhe 134/1/i të Kushtetutës, si dhe të neneve 72 e vijues të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me shumicë votash,⁵

VENDOSI:

- Rrëzimin e kërkesës.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë pro: Bashkim Dedja (kryetar), Vitore Tusha, Gani Dizdari, Fatmir Hoxha, Besnik Imeraj, Fatos Lulo

Anëtarë pjesërisht kundër: Vladimir Kristo

⁵ Gjyqtari V. Kristo votoi për shfuqizimin e vendimit të Gjykatës së Lartë, me arsyetimin se kjo e fundit duhet ta kalonte çështjen në seancë gjyqësore dhe të shqyrtonte pretendimin e kërkuarit nëse janë zbatuar detyrat e lëna nga vendimi i GJEDNJ-së.

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2017

Adresa:
Bulevardi “Gjergj Fishta”
pas ish-Ekspozitës “Shqipëria Sot”
Tel: 042427005, 042427006

Çmimi 308 lekë